REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

ARSIMI PROFESIONAL
(STRUKTURA 2+2)

LËNDA: HISTORI

KLASA: XI

Tiranë, 2017

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT TË HISTORISË

1. **HYRJE**

2. **KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT**

   2.1. Qëllimi i programit të historisë.

   2.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës.

   2.3. Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurrikuare.

   2.4. Lidhja e lëndës së historisë me fushat/lëndët e tjera kurrikulare.

   2.5. Kompetencat dhe konceptet historike.

   2.6. Cilësitë historike të nxënësit.

3. **KLASA 11 DHE KLASA 12**

   3.1. Përmbajtja e kurrikulës

   3.2. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike.

   3.3. Koha mësimore.

   3.4. Klasa e njëmbëdhjetë, aftësi/shkathtësi, qëndrime, koncepte dhe situata të sugjeruara.

   3.5. Klasa e njëmbëdhjetë, aftësi/shkathtësi, qëndrime, koncepte dhe situata të sugjeruara.

4. **UDHËZIME METODOLOGJIKE**

   4.1. Materiale dhe burime mësimore.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Aneks 1. Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI.

TABELA, DIAGRAMA DHE FIGURA

Diagrami 1. Korniza konceptuale e programit.

Diagrami 2. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë.

Diagrami 3. Lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe fushave/lëndëve të tjera.

Diagrami 4. Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë.

Diagrami 5. Cilësitë historike të nxënësit.

Tabela 1. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre.

Tabela 2. Konceptet e lëndës dhe përshkrimi.

Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike.

Tabela 4. Koha mësimore për tematikë për klasën dhjetë.

Tabela 5. Përforcimi i qasjes kërkimore.

Figura 1. Procesi i kërkimit historik.

1. HYRJE

Lënda e historisë është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsi, nëpërmjet kuptimit, analizës dhe përfundimeve të nxjerra nga përvojat e së shkuarës.

Studimi i lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë një ndjenjë humanizmi të gjerë, të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ata ngjasojnë dhe diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë vërtetësinë e burimeve historike, duke dalluar analogjinë false, të njohin abuzimet nga "mësimet" historike, të peshojnë pasojat që vijnë prej tyre, si dhe të marrin parasysh se padija për të shkuarën na bën "të burgosurit" e saj.

Ndryshimi është aspekti thelbësor i historisë dhe për këtë arsye është dhe një ndër konceptet bazë të studimit në programin e historisë. Ndërsa lëndë të tjera të fushës "Shoqëria dhe Mjedisi" studiojnë aspekte të ndryshme të jetës së njerëzimit, si: institucionet, traditat kulturore, ekonominë, ligjet etj., lënda e historisë kryesisht, synon të merret me shpjegimin e mënyrës se si të gjitha këto aspekte janë zhvilluar dhe kanë ndryshuar gjatë historisë së tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të mësojnë rëndësinë që ka ndryshimi për të gjitha përvojat njerëzore, për kompleksitetin dhe mënyrat e ndryshme në të cilat bashkëveprojnë të gjitha këto përvoja.

Detyra e programit të historisë është të drejtojë nxënësit për t'u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë se si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Nëpërmjet programit të historisë, nxënësit kuptojnë se kultura e tyre dhe kulturat e tjera përbëjnë rezultatin e një procesi historik.

Programi i historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe vendime të arsyetuara mirë.

Këto cilësi mbështesin nxënësit në zhvillimin e qëllimeve, kompetencave kyçe dhe rezultateve të dëshiruara të arsimit parauniversitar, në mënyrë që ata të jenë individë të përgatitur, të aftë për të kontribuar ndaj kombit dhe të aftë për t'iu përgjigjur zhvillimeve globale.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Hartimi i programit për lëndën e historisë në arsimin parauniversitar rrjedh nga Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikulat bërthamë, plani mësimor, dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI[i].

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së historisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësit në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara .
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit, të cilët përmes përmbushjes së qëllimeve të programit në tekstet e tyre, bëhen një faktor i rëndësishëm progresi në mësimdhënien e lëndës së historisë dhe në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës.

Programi i historisë në qendër të tij vendos krijimin e kushteve për ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to, për të gjithë nxënësit e arsimit bazë.

Programi paraqet temat ndërkurrikulare, ku realizimi i tyre nëpërmjet lëndës së historisë është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e historisë në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Programi përshkruan lidhjen e historisë me fushat e tjera

Diagrami 1. Korniza konceptuale e programit



2.1. Qëllimet e programit të historisë

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësit: të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;
- përdorin teknologjitë e reja.

Programi i historisë në arsimin parauniversitar ka për qëllim të pajisë nxënësit me aftësi dhe cilësi intelektuale nëpërmjet zhvillimit dhe ndërtimit të një sërë konceptesh dhe kompetencash lëndore, të cilat u krijojnë atyre mundësi të analizojnë në mënyrë kritike informacionin, lidhjet shkak-pasojë, të interpretojnë burimet, të ndërtojnë shpjegime të arsyetuara dhe argumentuara dhe të vlerësojnë interpretimet e ndryshme për të shkuarën.

Programi i historisë lidh vlerat e të mësuarit të historisë me qëllimet e arsimit parauniversitar, me kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe Rekomandimet Rek (2001)15 të Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare, për mësimdhënien e historisë në shekullin e XXI, duke ndërtuar tek nxënësi konceptet, kompetencat dhe cilësitë historike, nëpërmjet:

- pajisjes me dijet dhe kompetencat e nevojshme historike për të kuptuar të tashmen dhe ndikimin e saj në zhvillimet historike të së ardhmes.
- krijimit të mundësive për të ndërtuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, për zhvillimin e qytetërimeve antike, mesjetare moderne dhe bashkëkohore në vend, rajon dhe botë.
- angazhimit në mënyrë aktive në kërkimin historik me qëllim që të zhvillojë vetëbesimin, reflektimin dhe mendimin kritik.
- zhvillimit të aftësive/shkathtësive të kërkimit historik, duke u bazuar në burime historike për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë.
- interpretimit të efektit të kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes.
- interpretimit të historisë së shoqërisë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen
- kuptimit se si dhe pse ngjarje dhe çështje të veçanta historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme.
- zhvillimit të aftësive për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështje të ndjeshme historike.
- ndërveprimit me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike.
- mundësimit të ndërtimit të identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes dhe krahasimit së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët.
- vlerësimit të pozitës së qytetërimit shqiptar në raport me qytetërimet botërore.

- argumentimit të vlerave të trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli.
- zhvillimit të aftësive qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.
- ndërtimit të aftësive për të kuptuar, organizuar dhe komunikuar dijet e tyre historike përmes mënyrave të ndryshme dhe përdorimit të medieve të ndryshme.
- pajisjes me kompetencat e duhura për të kontribuar në mënyrë aktive dhe me përgjegjësi si qytetarë lokalë dhe globalë në ndërtimin e perspektivës.
- forcimit të ndjenjës së identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.

2.2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë të kurrikulës. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.

Organizimi i mësimit të historisë me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Nëpërmjet studimit të historisë, nxënësit mësojnë se si të paraqesin një problem, që ata e kanë realizuar nëpërmjet përvetësimit dhe ndërtimit të dijeve dhe kompetencave historike, për një teme të caktuar.

Kur nxënësi zbaton kompetencat historike, ai njëkohësisht është duke zbatuar dhe kompetencat kyçe. P.sh. kompetenca historike "Kërkimi historik", përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e

përditshme. Për të zgjidhur problemin, ata duhet të kërkojnë, të mbledhin, të gjejnë, dhe të sintetizojnë informacione nga burimet primare, sekondare dhe informacionet me gojë, me shkrim, dhe ato vizuale.

Ata duhet të dinë ku të kërkojnë informacion, cilat informacione do t'i ndihmojnë ata për të ndërtuar një argument, si të interpretojnë informacionin e gjetur, si të strukturojnë marrëdhëniet komplekse shkakore, si të vlerësojnë saktësinë e burimit dhe si të krahasojnë gjetjet e tyre me faktet historike. Ata mësojnë të komunikojnë gjetjet e tyre dhe i komunikojnë ato për audienca të ndryshme. Pra gjatë zhvillimit të kompetencave historike, nxënësi zhvillon gjithashtu kompetencat kyçe në lidhje me zgjidhjen e problemit, krijimtarinë, inovacionin, përpunimin e informacionit, prezantimin e detyrave, punën në grup, komunikimin efektiv etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës mësuesi ndjek këto hapa:

- Përzgjedh përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të historisë në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien, duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do të arrijë rezultatet e të nxënit, për kompetencat kyçe brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë, për lëndën e historisë.

Diagrami 2. Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së historisë

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

- Zhvillon kompetencën e komunikimit për të ndërtuar kompetencat historike për të shqyrtuar, për të analizuar, për të parashtruar pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar dhe për të komunikuar informacionin historik, konceptet dhe idetë.
- Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënive shkak-pasojë, përdorimin e gjerë të emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit dhe ngjarjet.

Kompetenca e të menduarit

- Zhvillon kompetencën e të menduarit për realizimin e kërkimit historik.
- Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të interpretuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumenta bazuar në burime dhe për të saktësuar saktësinë e burimeve;
- Zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës, që janë të diskuetueshme.
- Analizon të dhënat numerike për të kuptuar të shkuarën, për shembull për të kuptuar shkakun dhe pasojën, vazhdimësinë dhe ndryshimin.
- Ndërton dhe interpretojnë grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.

Kompetenca e të nxënit

- Zhvillon kompetencën e të nxënit për të shfrytëzuar të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore, duke i prezantuar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
- Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumenta dhe burime.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit sipas një radhitjeje logjike.
- Vlerëson pikëpamjet e ndryshme si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

- Zhvillon kompetencën për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin për të identifikuar dhe vlerësuar burimet e nevojshme për interpretimin e ngjarjes historike.
- Harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkimi historik për një ngjarje të dhënë.
- Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori.
- Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat e të ardhmes.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.

Kompetenca personale

- Zhvillon kompetencën personale për të kuptuar veten dhe të tjerët, ndryshimet dhe ngjashmëritë, për të menaxhuar marrëdhëniet ndërmjet njëri-tjetrit, vlerësuar pikëpamjet e të tjerëve qofshin këto dhe të ndryshme nga të tijat;
- Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, trashëgiminë kulturore, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.
- Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij;.

Kompetenca qytetare

- Zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe standardeve të ndryshme.
- Shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme, dhe shpegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësinë kulturore.
- Kupton se si qytetërimet dhe shoqëritë janë formuar nga grupe njerëzish me kultura të ndryshme, identifikon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet kulturave të ndryshme dhe kultivon respekt ndaj kulturave të ndryshme nga e tija;
- Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore.
- Zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme.
- Kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë e njohjes së historisë së tyre dhe të tjerëve;
- Shpjegon orrigjinën dhe zhvillimin e identitetit kombëtar duke vlerësuar trashëgiminë material dhe shpirtërore;
- Shqyrton një sërë burimesh që paraqesin perspektiva të ndryshme kulturore në mënyrë që të zhvillojë kuptimin historik.

Kompetenca digjitale

- Zhvillon kompetencën digjitale për të kërkuar, për të përzgjedhur, për të analizuar dhe për të komunikuar informacion historik.
- Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime historike;
- Komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.
- Bashkëpunon, diskuton dhe debaton me të tjerët për të ndërtuar konceptet dhe kompetencat historike;

2.3. Lidhja e lëndës së historisë me temat ndërkurrikuare

Kurrikulat bërthamë të arsimit parauniversitar përcaktojnë një sërë temash ndërkurrikulare, të cilat integrojnë fushat kurrikulare të të nxënit. Ato janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Zhvillimi i tyre ndihmon nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Trajtimi i këtyre temave në lëndën e historisë synon ndërtimin e disa njohurive specifike, zbatimin e disa aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara te nxënësit për zhvillimin e tyre si qytetarë të së ardhmes, të cilët do të jenë të aftë për të bashkëvepruar në paqe me kultura të ndryshme, të aftë për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të aftë për të funksionuar në një botë të ndërvarur, duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Kurrikula e historisë është projektuar për të plotësuar nevojat e nxënësve duke paraqitur një program bashkëkohor. Temat ndërkurrikulare:

- identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave,
- të drejtat e njeriut, vendimmarrja morale,

- zhvillimi i qëndrueshëm,
- mjedisi, ndërvarësia,
- bashkëjetesa paqësore

ofrojnë dimensione, të cilat pasurojnë programin mësimor nëpërmjet zhvillimit të përmbajtjes së fokusuar që përshtatet natyrshëm brenda tematikave të historisë.

Integrimi i këtyre temave gjatë zhvillimit të koncepteve dhe kompetencave historike aftëson nxënësit:

- për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale, duke u mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- për t'u edukuar me ndenjën e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë;
- për të ndihmuar në formimin e një të ardhmeje më të mirë përmes kuptimit të asaj se si e shkuara ka lidhje me të tashmen dhe për të marrë vendime për një zhvillimi të qëndrueshëm të perspektivave historike;
- për të zhvilluar aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.

Gjatë realizimit të temave ndërkurrikuar nxënësi duhet të zgjidhë situata, duhet të përdorë aftësitë e mendimit kritik, krijues, të përdorë kompetencat historike si: kërkimin, përdorimin e burimeve, interpretimin dhe komunikimin për të shpjeguar, argumentuar dhe parashikuar perspektivat për çështje të ndryshme që lidhen me këto tema ndërkurrikulare.

2.4. Lidhja e historisë me fushat/lëndët e tjera kurrikulare

Lënda e historisë është një nga lëndët kryesore të fushës shoqëria dhe mjedisi. Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në lëndët e fushës shoqëria dhe mjedisi dhe në lëndët e tjera të fushave të të nxënit si: atyre të shkencave natyrore, arteve, gjuhës dhe komunikimit, matematikës, teknologjisë dhe TIK-ut, etj., integrohen mjaft mirë me ato të historisë. Integrimi i tyre mund të shikohet në nivelin e tematikave, të koncepteve dhe të kompetencave.

Lënda e historisë dhe lëndët e tjera duhet të integrohen në mënyrë të ndërsjellë me njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet kompetencat kyçe të të nxënit dhe qëllimet e shkollës dhe të shoqërisë, në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, historia mund të përdorë njohuritë, konceptet dhe aftësitë, që trajtohen në lëndët e tjera për të ndërtuar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e saj.

- Së dyti, lëndët e tjera duhet të përdorin dijet dhe kompetencat historike për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Diagrami 3. Lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe fushave/lëndëve të tjera

SHOQËRIA DHE MJEDISI

- Përdor hartën, globin dhe busullën për lokalizimin e territoreve ku kanë lindur dhe janë zhvilluar ngjarjet historike.
- Lexon dhe interpreton harta të ndryshme historike dhe gjeografike.
- Orientohet në hapësirë nëpërmjet hartës dhe globit, për të lokalizuar një territor të caktuar me vlera historike.
- Përcakton në hartë vendndodhjen e qytetërimeve ne periudha të ndryshme historike.
- Argumenton rëndësinë e relievit dhe të klimës në zhvillimin e qytetërimeve.
- Shpjegon termat migrim i jashtëm dhe i brendshëm i popullsisë, për të treguar lëvizjet e popujve dhe pasojat që ato sjellin në qytetërime, gjatë periudhave të ndryshme të historisë.
- Tregon ç'është mjedisi gjeografik, për të kuptuar ndikimin e tij në zhvillimin e qytetërimeve.
- Shpjegon konceptet: liri, barazi, të drejta, ligj, komb, shtet, etni, demokraci dhe kushtetutë, për të Shpjeguar zhvillimin historik të qytetërimeve.
- Analizon dhe interpreton organizimin e familjes, të institucioneve dhe të shoqërisë, për të përcaktuar tiparet e jetës së përditshme përgjatë periudhave historike.
- Shpjegon format e sistemeve të qeverisjes, për të shpjeguar organizimin shtetëror gjatë peri[illegible] historike.
- Interpreton besimet e ndryshme fetare (politeizmi, monoteizmi, kri[illegible] për të shpjeguar rolin e fesë në histori.

GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

- Interpreton tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit, përfshirë atë historik.
- Shpreh opinione, arsyeton, diskuton, argumenton dhe bën debate argumentuese me tematikë historike.
- Përzgjedh informacionin e duhur historik në tekst.
- Shfrytëzon rregullat e drejtshkrimit për shkrimin e një materiali historik.
- Dallon gjinitë e ndryshme letrare: ditarin, kujtimet dhe romanin historik.
- Shfrytëzon veprat letrare-artistike, si burim informacioni historik.
- Përdor folklorin shqiptar si burim historik.
- Përdor veprën e rilindësve për të vlerësuar rolin që luajtën ata në historinë e Shqipërisë.

HISTORIA

Kërkimi historik;
Përdorimi i burimeve;
Analiza shkak-pasojë
Interpretimi;
Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

MATEMATIKË

- Ndërton dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela statistikore, për paraqitjen e të dhënave historike.
- Përdor numrat e shifrat romake për leximin dhe për shkrimin e shekujve.
- përdor numrat negativë dhe pozitivë për të kryer veprime për llogaritjen e kohës.
- Përdor boshtin numerik për interpretimin e shkallës së kohës.
- Vendos në boshtin numerik vitet para dhe pas Krishtit.

- Shfrytëzon simbolet per [illegible] e shekujve me shifra romake në kompjuter.
- Përdor programet kompjuterike për shkrimin e një materiali historik.
- Përdor programet kompjuterike për prezantimin e një detyre në histori.
- Përdor internetin për nxjerrjen e të dhënave për ngjarje dhe për figura historike.
- Përdor programet kompjuterike për të ndarë mendime detyra dhe informacionin historik me moshatarët e tij.

SHKENCAT E NATYRËS

Reflekton dhe diskuton për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve shkencore.

Vlerëson rolin qendror të shkencës në botën e sotme.

Kupton karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.

Kupton çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, për shembull.

Kupton ndikimin e përparimeve teknike në shoqëri, për shembull: ndikimi i internetit.

2.5.Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë

Programi nëpërmjet të gjithë tematikave të tij zhvillon dhe ndërton një numër kompetencash dhe konceptesh, të cilat mbështesin studimin e historisë. Kompetencat historike janë procese dhe aftësi thelbësore që përfshihen në të gjithë programin e historisë nëpërmjet tematikave dhe nëpërmjet tematikave dhe veprimtarive të sugjeruara. Nxënësit duhet të kuptojnë, të zhvillojnë dhe të ndërtojnë kompetencat dhe konceptet historike si dhe të aftësohen për ti përdorur ato në mënyrë që të thellojnë dhe të zgjerojnë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre në lëndën e historisë duke arritur progres.

Kompetenca historike janë:

1. Kërkimi historik.
2. Përdorimi i burimeve.
3. Analiza shkak - pasojë.
4. Interpretimi historik.
5. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.

Koncepte kyçe historike janë:

1. Kuptimi kronologjik.
2. Ndryshimi dhe vazhdimësia.
3. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare.
4. Rëndësia.

Diagrami 4. Kompetencat dhe konceptet e lëndës së historisë



Tabela 1. Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

PËRSHKRIMI I KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	**Përdorimi i burimeve**	**Interpretimi historik**	**Analiza shkak-pasojë**	**Shpjegimi & komunikimi për të shkuarën**
Kërkimi historik përfshin strukturimin e kërkesave në lloje të ndryshme pyetjesh dhe çështjesh historike. Nxënësit duhet të fillojnë të hartojnë dhe të përmirësojnë pyetjet e tyre për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tyre. Nxënësit mund të përdorin njohuritë e tyre të fituara për të sugjeruar hipoteza, ose mund të sugjerojnë hipoteza në fillim të temës, bazuar në supozimet dhe vlerat e tyre, të cilat ata pastaj i testojnë kundrejt provave.	Njohja e së kaluarës bazohet në fakte historike, në prova, të cilat rrjedhin nga burime të sakta historike dhe jo nga supozime paraprake në lidhje me vlefshmërinë dhe me besueshmërinë e burimeve historike të përdorura. Kjo përfshin vlerësimin e vlerës dhe besueshmërinë e dëshmive, duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.	Interpretimi ka të bëjë me të kuptuarit se si historianët dhe të tjerët formojnë interpretime. Njerëzit përfaqësojnë dhe interpretojnë të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj. Interpretimet reflektojnë rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues).	Analiza shkak-pasojë përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rëndësisë relative të faktorëve të ndryshëm, si dhe bërjen e lidhjeve shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.	Nxënësit zhvillojnë dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik, duke përdorur me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën. Nxënësit duhet të përdorin edhe teknologjitë e reja ekzistuese sipas nevojave të tyre.

Tabela 2. Konceptet e lëndës dhe përshkrimi i tyre

PËRSHKRIMI I KONCEPTET HISTORIKE			
Kuptimi kronologjik	**Ndryshimi & vazhdimësia**	**Shumëllojshmëria kulturore, etnike & fetare**	**Rëndësia**
Kuptimi kronologjik është thelbësor në ndërtimin dhe në shpjegimin e ngjarjeve historike, ç'ka përfshin përdorimin e saktë të datave për të krijuar vijimësinë e ngjarjeve në një shqyrtim, duke përdorur termat dhe fjalorin e saktë kronologjik, si dhe duke ditur emrat dhe karakteristikat kryesore të periudhave të studiuara. Nxënësit duhet të identifikojnë ndryshimet brenda dhe gjatë periudhave, duke bërë lidhjet midis tyre.	Kuptimi i ndryshimit dhe i vazhdimësisë është i lidhur ngushtë me identifikimin dhe shpjegimin e ndryshimit, e vazhdimësisë brenda dhe përgjatë periudhave historike, si dhe me kuptimin e temave dhe çështjeve gjithëpërfshirëse të periudhave historike.	Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare ka të bëjë me të kuptuarin e përvojave, ideve, besimit dhe vlerave të ndryshme të njerëzve dhe të shoqërive në të shkuarën dhe se si të gjitha këto kanë formësuar botën. Nxënësit duhet të njihen me shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare të shoqërive të ndryshme. Shumëllojshmëria ekziston brenda dhe ndërmjet grupeve për shkak të dallimeve kulturore, etnike, rajonale, gjuhësore, sociale, ekonomike, teknologjike, politike dhe fetare. Njohja e kulturave duhet të arrihet nëpërmjet studimit të individëve dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, si p.sh.: njohjes të pakicave kombëtare, të shoqërive evropiane dhe atyre joevropiane.	Rëndësia ka të bëjë me konsiderimin dhe me vlerësimin e një ngjarjeje historike. Ajo vlerëson pse gjykimet në lidhje me rëndësinë e ngjarjeve historike, çështjeve dhe njerëzve kanë ndryshuar me kalimin e kohës. Gjithashtu, ajo merr parasysh identifikimin e kritereve të përdorura për vlerësimin e rëndësisë së një çështje, ngjarje apo personazhi historik, si dhe vlerëson se si këto kritere dhe vlera janë përdorur në përshkrimet e së shkuarës dhe shpjegimin e së tashmes. Deklaratat rreth rëndësisë janë interpretime që mund të bazohen në vendime të kontestueshme rreth ngjarjeve, çështjeve dhe figurave historike, ato shpesh janë të lidhura me sistemet e vlerave të periudhës, në të cilën është shkruar interpretimi.

2.6.Cilësitë historike të nxënësit

Lënda e historisë i ndihmon nxënësit që të bëhen të ditur, të logjikshëm, kureshtarë, të balancuar, të ndjeshëm, dhe individë të aftë për të dhënë argumente dhe për të marrë vendime të arsyetuara mirë.

Diagrami 5. Cilësitë historike të nxënësit



Kurrikula e historisë synon t‘i pajisë nxënësit me këto cilësi të rëndësishme në mënyrë që t‘i mbështesë ata, jo vetëm në zotërimin e dijeve dhe kompetencave historike, por dhe në arritjen e rezultateve të dëshiruara dhe në realizimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, për t‘i bërë ata të aftë për të përmbushur studimet e tyre të mëtejshme, si dhe për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Për të zhvilluar cilësitë historike, mësuesi gjatë mësimit të historisë duhet t’u ofrojë nxënësve mundësi për të kërkuar, për të shqyrtuar, për të vlerësuar aspekte të ndryshme historike dhe për të përdorur TIK-un, si pjesë përbërëse e të mësuarit të tyre. Krijimi i këtyre mundësive rrit angazhimin e nxënësve me kuptimin dhe përdorimin e njohurive të lëndës, koncepteve, kompetencave historike dhe kompetencave kyçe.

Mësuesi i ofron mundësi nxënësit:

- për të kërkuar aspekte për historinë e shqiptarëve dhe historinë qytetërimeve botërore në antikitet, në mesjete, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore dhe për të kuptuar se si ato lidhen me një kontekst të gjerë historik;
- për të shqyrtuar rrugët, në të cilat e kaluara i ka ndihmuar të formojnë identitetin, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot;
- për të vlerësuar përmes vizitave ku është e mundur, rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës;
- për të përdorur TIK-un, për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet.

Nxënësi:

- Kërkon aspekte për historinë e qytetërimeve në antikitet, në mesjetë, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore për vendin, Evropën dhe më gjerë për të kuptuar se si ngjarjet lidhen me një kontekst të gjerë historik. Duke bërë kërkime mbi historinë e qytetërimeve në antikitet, në mesjetë, në periudhën moderne dhe në periudhën bashkëkohore, nxënësit i krijohet

mundësia të përdorë burimet për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, marrëdhëniet shkak-pasojë, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, duke krijuar te nxënësi bindjen se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të.

- Shqyrton rrugët në të cilat e kaluara i ka ndihmuar të formojnë identitetin, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot. Kjo përfshin: eksplorimin e marrëdhëniet në mes të kaluarës dhe të tashmes, të kuptuarit që idetë, vlerat, besimet rrjedhin nga një proces ndryshimi dhe ndërveprimi i vazhdueshëm, duke vlerësuar atë që njerëzit brenda një kulture kanë të përbashkët, si dhe diversitetin e tyre, duke vlerësuar se kulturat janë gjithmonë në ndryshim si rezultat i kontaktit me kulturat e tjera. Duke studiuar rrugët në të cilat e kaluara ndihmon për të formuar identitetet, kulturat e përbashkëta, vlerat dhe qëndrimet sot, nxënësit përgatiten për jetën në një shoqëri të ndryshme dhe me shumë etni, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.
- Vlerëson përmes vizitave ku është e mundur rolin e muzeve, galerive, arkivave historike në ruajtjen dhe paraqitjen e së shkuarës. Kjo përfshin përdorimin e muzeve, galerive, arkivave dhe vende historike për të gjeneruar dhe për t‘iu përgjigjur pyetjeve rreth të shkuarës dhe për të ngjallur interesin e nxënësve, në mënyrë që ata në jetën e tyre përtej shkollës, të vazhdojnë përdorimin e këtyre burimeve.
- Përdor TIK-un për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet. Kjo përfshin: vlerësimin e faqeve të internetit, duke marrë parasysh prejardhjen e materialeve dhe duke vlerësuar vlerën e tyre, si dhe përdorimin e TIK-ut për të kërkuar të dhëna historike, për të përzgjedhur, për të klasifikuar, për të organizuar dhe për të prezantuar informacionin. Nxënësi duhet të ketë mundësi për të ripunuar, për të ristrukturuar punën e tyre dhe për të reflektuar mbi këtë proces.

3. SHKALLA E PESTË

KLASA E NJËMBËDHJETË & DYMBËDHJETË

Programi i historisë i përgatit nxënësit për të ardhmen, i pajis ata me cilësi dhe kompetenca, që janë të çmuara për jetën, rrit mundësinë e arsimimit të mëtejshëm dhe zhvillon aftësitë për të marrë pjesë në një shoqëri demokratike. Ai inkurajon mirëkuptimin reciprok të origjinës historike dhe të diversiteteve etnike, kulturore dhe fetare.

Programi i historisë, gjatë shkallës së pestë të kurrikulës synon që të krijojë te nxënësi bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak – pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike. Trajtesa tematike e historisë shpreh natyrën përzgjedhëse (selektive) të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë gjithë ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet

aktuale që ndodhin, t'i analizojë ato në mënyrë kritike, duke bërë lidhjen e të sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes.

Gjatë shkallës së pestë nxënësit nëpërmjet programit të historisë zhvillojnë dhe ndërtojnë njohuritë, aftësitë/shkathtësi, qëndrimet dhe vlerat e tyre në njohjen dhe kuptimin e karakteristikave kryesore të periudhave antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, për vendin, bëjnë lidhjet midis shoqërive, ngjarjeve dhe zhvillimeve në të shkuarën dhe në ditët e sotme, identifikojnë ngjarjet idetë dhe figurat historike që i dhanë formë zhvillimit të konteksteve politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, bëjnë lidhjet midis historisë së shqiptarëve dhe historisë së qytetërimeve botërore për periudhat historike të marra në studim, përdorin kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik, kuptojnë procesin e ndryshimit, duke treguar ndryshimin dhe/ose zhvillimin brenda dhe gjatë periudhave të studimit, si dhe mbështeten në burimet historike (burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik) dhe teknologjinë, për të nxjerrë përfundime të arsyetuara dhe logjike.

Nxënësit aftësohen të demonstrojnë kompetencat historike për ndërtimin e ngjarjes historike**.** Ata shtrojnë pyetje rreth ngjarjeve, çështjeve apo zhvillimeve, krahasojnë aspekte të ndryshme të periudhave, ngjarjeve dhe çështjeve të marra në studim, për të kuptuar ndryshimin dhe vazhdimësinë, shqyrtojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve dhe situatave historike, vendosin rëndësinë historike të një ngjarjeje në shoqëri, interpretojnë dhe marrin informacion nga burime të ndryshme për të mbështetur kërkimin historik, identifikojnë pikëpamjet e ndryshme historike, organizojnë dhe komunikojnë në mënyrë koherente dijet historike.

Të mësuarit dhe ndërmarrja e aktiviteteve në histori kontribuon në arritjen e qëllimeve të programit mësimor për të gjithë nxënësit, për t'u bërë:

- nxënës të suksesshëm që kënaqen nga mësimi dhe bëjnë përparim e arritje;
- individë me besim, të cilët janë në gjendje të jetojnë të sigurt, të shëndetshëm dhe të aftë të përmbushin kërkesat e jetës;
- qytetarë të përgjegjshëm që japin kontribut pozitiv në shoqëri.

3.1.Përmbajtja e kurrikulës

Programi i historisë për arsimin profesional në strukturën 2+2, në klasën e 11-të dhe të dymbëdhjetë, trajton historinë e Shqiptarëve në periudhën antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë jetën dhe ngjarjet e së shkuarës, lidhjen e tyre me të tashmen dhe me të ardhmen, si dhe ndërvarësinë ndërmjet qytetërimeve.

Në klasën e 11-të & 12-të, programi "Historia e shqiptarëve" studion tërë aspektet e jetës shoqërore si shteti, ligji, zhvillimi ekonomik, shoqëria, kultura materiale dhe shpirtërore si dhe veprimtaritë e jetës së përditshme, duke u përpjekur të vendosë një raport të baraspeshuar ndërmjet këtyre fushave të jetës. Programi trajton historinë e shqiptarëve nga periudha parahistorike deri në ditët tona. Nxënësi nëpërmjet tij kupton ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, analizon ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përshpejtuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme historike të popullit shqiptar si dhe vlerëson ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej. Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, duke i kuptuar ato në mënyrë kritike, për të bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes.
Studimi i përvojës së shqiptarëve në të kaluarën, veçoria dhe larmia e saj është e domosdoshme që nxënësi të kuptojë kushtet shoqërore dhe shtysat e saj. Duke njohur përmes fakteve përvojën e kaluar të bashkësisë ku jeton, nxënësi thellohet në zbulimin dhe kuptimin e rrënjëve të identitetit të tij dhe të traditave të trashëguara.

Përmbajtja e dhënë në programin e historisë ofron mundësi për zhvillimin dhe ndërtimin e koncepteve, njohurive, aftësive/shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat janë të ndërlidhura me njëra – tjetrën dhe duhet të jepen në mënyrë të integruar në të gjithë tematikat e përcaktuara në program, me qëllim ndërtimin dhe zbatimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave

kyçe. Tematikat dhe projektet/situatat e sugjeruara të dhëna në program janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit, sipas koncepteve dhe kompetencave historike. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat për secilën klasë të shkallës së pestë të kurrikulës.

3.2.Rezultatet e të nxënit për konceptet dhe kompetencat historike

Përgjatë gjithë programit të historisë zhvillohen njohuritë, aftësitë/shkathtësitë, qëndrimet e vlerat që duhet të zotërojë nxënësi për ndërtimin e koncepteve historike*: Kuptimi kronologjik. Ndryshimi dhe vazhdimësia. Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, rëndësia* dhe realizimin e kompetencave historike: *Kërkimi historik. Përdorimi i burimeve. Analiza shkak-pasojë. Interpretimi. Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.*

Tabela 3. Rezultatet e të nxënit për kompetencat dhe konceptet historike

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KOMPETENCAT HISTORIKE				
Kërkimi historik	**Përdorimi i burimeve**	**Interpretimi historik**	**Shkaku dhe pasoja**	**Shpjegimi dhe komunikimi**
• Identifikon dhe shqyrton, individualisht dhe si pjesë e një grupi, pyetje specifike historike për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore	• Shpjegon tipat e burimeve historike si një domosdoshmëri në punën e historianit dhe në dhënien e përgjigjeve të argumentuara për ndërtimin e ngjarjes historike; • vlerëson historinë gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e	• Kupton pse historianët dhe të tjerët i kanë interpretuar ngjarjet, njerëzit dhe situatat historike që i përkasin periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në	• Analizon ngjarjet historike që i përkasin periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në lidhjet e tyre shkak-pasojë; • shpjegon pasojat	• Paraqet shpjegime për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore që janë koherente, të strukturuara dhe të arsyetuara, duke përdorur

ose çështje që u përkasin këtyre periudhave, duke bërë testimin e hipotezave; • reflekton në mënyrë kritike për pyetje ose çështje historike që i përkasin periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore;	nxënësve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në "historinë e shkruar"; • kërkon, duke vlerësuar burimet alternative, për ndërtimin e ngjarjes historike për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • identifikon, zgjedh dhe përdor një sërë burimesh historike, duke përfshirë burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin historik për të argumentuar interpretimin e tij në lidhje me ngjarje apo çështje të caktuara që i përkasin periudhave antike mesjetare moderne dhe bashkëkohore; • vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore;	mënyra të ndryshme; • shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme nëpërmjet një sërë mediesh; • shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës që i përkasin periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre.	në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike që i përkasin periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore.	kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik; • komunikon njohuritë historike për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore në mënyra të ndryshme, duke përdorur kronologjinë dhe fjalorin e duhur historik.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR KONCEPTET HISTORIKE			
Kuptimi kronologjik	**Ndryshimi dhe vazhdimësia**	**Shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare**	**Rëndësia**
• Përdor saktë datat dhe fjalorin e duhur historik për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • kupton organizimin kronologjik të historisë	• Shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve historike brenda dhe përtej periudhave historike(parahistorike, antike, mesjetare, moderne,bashkëkohore);	• Kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje	• Vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe

dhe vendos njerëzit dhe ngjarjet në periudhën e saktë historike(parahistorike, antike, mesjetare, moderne,bashkëkohore), duke kuptuar dhe duke shpjeguar marrëdhëniet historike; • ndërton linjën e kohës, duke vendosur në të periudhat historike dhe ngjarjet e rëndësishme historike; • kryen veprime për llogaritjen e kohës; • krijon një tabelë kronologjike(për vendin dhe botën) të periudhave historike, duke e pasuruar atë në vazhdimësi me informacionin e ri.	• analizon shkallën dhe ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë për ngjarje historike që i përkasin periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • analizon arsyet dhe rezultatet e ngjarjeve, e situatave dhe ndryshimeve historike për periudhën antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore; • kupton dhe ndërgjegjësohet për veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave (antike, mesjetare, moderne,bashkëkohore), të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, evropiane dhe botërore.	historike që i përket periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike.	të zhvillimeve historike që i përkasin periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore e në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme.

Tabela 6. Koha mësimore për çdo tematikë dhe temë në klasën e njëmbëdhjetë

KLASA 11		
NR.	**PROCESET HISTORIKE, KOHA, NDRYSHIMI DHE VAZHDIMËSIA**	**72**
1.	Parahistoria dhe antikiteti në territoret Shqiptare	10
2.	Territoret Shqiptare në mesjetë	8
3.	Shqiptarët në fund të Shek. XIV – fillimi i Shek. XX	16
4.	Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939	2
KLASA 12		
5.	Shqipëria dhe shqiptarët 1912 – 1939	10
6.	Shqiptarët dhe Lufta e Dytë Botërore	7

7.	Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990	12
8.	Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë	7

KLASA 11

TEMATIKA 1. PARAHISTORIA DHE ANTIKITETI NË TERRITORET SHQIPTARE

Përshkrimi i tematikës	
Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi periudhën parahistorike, avancimin e kulturave të para dhe mënyrën e jetesës në parahistori. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësit do të kuptojnë dhe gjykojnë për ndryshimet që solli lindja e bujqësisë dhe zbulimi i metalit në jetën e njeriut. Kjo tematikë do t'i pajisë nxënësit me njohuri dhe me shprehi për ilirët dhe qytetërimin e tyre**,** shtrirjen, mënyrat e jetesës, organizimin shtetëror, kulturën ilire dhe ndikimi e kulturave fqinje greke dhe romake në territorin ilir. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në **10 orë mësimore.** Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë projektesh/situata të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën "Projekte/situata të sugjeruara", në raportin 70% me 30%. Këto orë kanë për qëllim të vendosin nxënësin në pozitën e një historiani, si një zbulues (eksplorues) dhe mbledhës faktesh e dokumentesh, përzgjedhës, gjurmues (hulumtues) e vlerësues, i aftë për të mbajtur qëndrimin e tij për ngjarje të ndryshme historike, duke u bazuar në burime historike. Nëpërmjet tyre nxënësi demonstron kompetencat e lëndës dhe kompetencat kyçe te zhvilluara gjatë orëve mësimore. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
Klasa 11 **Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës**	**Klasa 11** **Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**
Periudha parahistorike Gjurmë të parahistorisë në territoret shqiptare	• identifikon ekzistencën e kulturave parahistorike dhe avancimin e këtyre kulturave; • përcakton në hartë qendrat e banuara parahistorike; • evidenton veçoritë e organizimit shoqëror në parahistori • shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndryshimit të shoqërisë në parahistori • shpjegon procesin e kalimit nga epoka e gurit në atë të metaleve; • gjykon ndryshimet që solli lindja e bujqësisë dhe zbulimi i metaleve në

	jetën e njeriut.
Qytetërimi ilir Ilirët: prejardhja dhe shtrirja e tyre Organizimi ekonomik dhe shoqëror i ilirëve Shteti Ilir Shteti i Epirit Mbretëria Dardane Iliria nën Perandorinë Romake	• evidenton tezat e ndryshme për etnogjenezën e ilirëve; • përcakton në hartë shtrirjen e fiseve kryesore ilire; • evidenton tiparet e qytetërimit ilir; • përcakton në hartë shtrirjen e kolonive greke në territorin ilir; • gjykon rolin që luajtën kolonitë greke në shkëmbimin kulturor ndërmjet dy qytetërimeve; • dallon tiparet ekonomike e shoqërore të fiseve ilire nga shek. V deri në shek. II para Krishtit; • përcakton format e organizimit dhe mënyrat e jetesës së shoqërisë ilire; • përcakton format kryesore të organizimit shtetëror në territoret ilire (konfederata fisnore dhe mbretëritë ilire); • vlerëson kontributin e mbretërive ilire dhe drejtuesve të tyre në zhvillimin e qytetërimit ilir; • përcakton në hartë shtrirjen e shtetit të Epirit; • shpjegon format kryesore të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të shtetit të Epirit; • vlerëson rolin e shtetit të Epirit në qytetërimin ilir; • përcakton në hartë shtrirjen e mbretërisë Dardane; • shpjegon tiparet kryesore të organizimit politik, ekonomik dhe shoqëror të mbretërisë Dardane; • vlerëson rolin e mbretërisë së Dardanisë në qytetërimin ilir; • gjykon mbi ndryshimet që pësoi jeta dhe kultura ilire gjatë sundimit romak; • vlerëson disa burime historike për kulturën ilire, gjuhën, simbolet,

	monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët, praktikat e varrimit dhe besimin;

Koncepte dhe terma

Parahistori, paleolit, neolit, eneolit, bronz; matriarkat, patriarkat, etnogjenezë, Ilir; mbretëri, paganizëm, autokton, barbar, tuma, urna, terrakota, federata fisnore; palafite; bazileu; shtet federativ; Lidhje Molose; Aleanca Epirote, provincë; kolonë; koloni helene;

Projekte/situata të sugjeruara për tematikën "Parahistoria dhe antikiteti në territoret shqiptare"

Nga pellazgët te ilirët

- ballafaqon tezat pro dhe kundër, të prejardhjes së ilirëve

Vizitë në muze ose në një zonë arkeologjike /historike

- vëzhgon gjurmë të qytetërimit ilir në territoret shqiptare

Burimet e shkruara greke e romake për Ilirinë

- gjykon mbi burimet e shkruara greke e romake për zhvillimin e qytetërimit Ilir

TEMATIKA 2. TERRITORET SHQIPTARE NË MESJETË

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi territoret shqiptare në mesjetë. Kjo tematikë ka për qëllim të shpjegojë vazhdimësinë ilire-arbërore, ndarjen e Perandorisë Romake dhe ndryshimet që pësuan territoret shqiptare në Perandorinë Bizantine. Tematika përshkruan veçoritë kryesore të principatave arbërore gjatë shek. XII-XV (Principata e Arbrit, Balshajve, Topiajve, Kastriotëve, si dhe ndryshimet kryesore që solli zhvillimi i marrëdhënieve feudale në territoret arbërore. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësit njihen me karakteristikat kryesore të qyteteve mesjetare arbërore, kulturën, artin dhe shoqërinë gjatë mesjetës.

Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në **8 orë mësimore**.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë projektesh/situata të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën "Projekte/situata të sugjeruara", në raportin 70% me 30%. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Klasa 11 Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Klasa 11 Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

Mesjeta e hershme arbërore, vazhdimësia etno-kulturore (shek V-X) Arbëria mes Bizantit dhe Perëndimit: • zhvillimet politike (shek XI-XIV) • ekonomia dhe shoqëria në qytetin dhe fshatin mesjetar arbëror. Organizmi politik në Arbërinë e shek. XIV-XV Arti, kultura, besimi, letërsia dhe arsimi në Arbërinë mesjetare	• shqyrton të dhënat arkeologjike dhe historike që tregojnë vazhdimësinë ilire-arbërore; • gjykon për pasojat e dyndjeve sllave në Ballkan dhe territoret shqiptare; • evidenton ndryshimet që pësuan territoret shqiptare në Perandorinë Bizantine; • përshkruan tiparet kryesore të organizimit politik e shoqëror të Principatës së Arbrit; • vlerëson rolin e Principatës së Arbrit si organizim shtetëror; • analizon faktorët që ndikuan në lindjen e marrëdhënieve feudale; • përcakton karakteristikat e qytetit dhe fshatit mesjetar arbëror dhe përshkruan mënyrat e jetesës në to; • përcakton në hartë shtrirjen e Principatave Arbërore (shek. XIV-XV); • analizon veçoritë ekonomike, politike dhe shoqërore të principatave shqiptare gjatë shek. XIV-XV; • tregon disa nga aspektet e zhvillimit të artit, kulturës, letërsisë dhe arsimit në Arbërinë mesjetare • përcakton kushtet e përhapjes dhe organizimit të besimit të krishterë në Arbërinë mesjetare;
Koncepte dhe terma Arbër; asimilim; sllavë; principatë; kodikë; pronja; bashtina; statut; kultura e Komanit; vasalitet; sundim dinastik, epitaf; ikonë, despot, Despotat, korporatë, metropol i Ilirikut; toponimi.	
Projekte/situata të sugjeruara për tematikën "Territoret shqiptare në mesjetë" **Despotati i Epirit** • vlerëson krijimin e despotatit të Epirit; • tregon ecurinë historike të despotatit; • prezanton faktorët e rënies së despotatit dhe rivendosjes së sundimit bizantin. **Diskutim:** Arti, kultura dhe besimi në Arbërinë mesjetare	

• rendit disa të dhëna për kulturën arbërore, si: gjuhën, simbolet, besimin, monedhat, ndërtimet, veshjet, veglat e punës, armët; marrëdhëniet martesore; etj;

TEMATIKA 3. SHQIPTARËT NË FUND TË SHEK. XIV – FILLIMIN E SHEK. XX

Përshkrimi i tematikës	
Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi historinë e shqiptarëve në periudhën e fundshekullit të XIV deri në fillim të shekullit XX. Ajo evidenton momentet kryesore të qëndrimit të klasës feudale shqiptare dhe ballkanike ndaj sulmeve të para osmane; shpjegon momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut, shkaqet e thirrjes së kuvendit të Lezhës, rëndësinë e tij; tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriot Skënderbeut, tiparet e jetës së përditshme, marrëdhëniet e tij me shtetet e tjera dhe vlerëson rëndësinë historike që pati periudha e Skënderbeut. Tematika analizon zhvillimin ekonomik e shoqëror të qyteteve shqiptare në shek. XVII-XVIII dhe faktorët që ndikuan në përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare. Ajo tregon rrugën e formimit të pashallëqeve (Shkodrës, Janinës) dhe reformat e ndërmarra nga to, si dhe aspekte të jetës së përditshme në këto pashallëqe. Tematika përshkruan zhvillimin e artit, e kulturës, e arkitekturës, e arsimit dhe fesë gjatë kësaj periudhe. Përmes kësaj tematike, nxënësit aftësohen për periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare: evidentojnë kushtet historike të lindjes së Rilindjes Kombëtare dhe rolin e elitës intelektuale shqiptare në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare; vlerësojnë programin e Rilindjes Kombëtare, platformën dhe organizimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, momentet kyçe të lëvizjes kulturore-arsimore evidenton rëndësinë e mësonjëtores së Korçës, Kongresit të Manastirit dhe atë të Elbasani; shpjegojnë veçoritë e kryengritjeve antiosmane gjatë viteve 1911-1912 dhe karakterin kombëtar dhe autonomist të Memorandumit të Greçes. Analizojnë evolucionin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare deri në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në **16 orë mësimore**. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë projektesh/situata të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën “Projekte/situata të sugjeruara”, në raportin 70% me 30%. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
Klasa 11 **Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës**	**Klasa 11** **Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**

Ardhja e osmanëve në Ballkan dhe qëndresa ballkano-arbërore (fundi i shek. XIV – fillimi i shek. XV) Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe Besëlidhja e Lezhës Qëndresa e shqiptarëve kundër osmanëve dhe diplomacia e shtetit të Skënderbeut	• përcakton arsyet e ardhjes së osmanëve në Ballkan dhe territoret shqiptare; • vlerëson qëndrimin e klasës feudale shqiptare dhe asaj ballkanike ndaj sulmeve të para osmane; • evidenton përpjekjet për qëndresë ndaj osmanëve; • përcakton momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut. • shpjegon shkaqet e thirrjes së Kuvendit të Lezhës; • analizon vendimet e Kuvendit të Lezhës duke vlerësuar rëndësinë e tyre; • analizon tiparet e shtetit nën drejtimin e Gjergj Kastriot Skënderbeut; • gjykon mbi marrëdhëniet e Skënderbeut me shtetet e tjera dhe vlerëson rolin e tij si diplomat; • vlerëson rëndësinë historike të periudhës së Skënderbeut për kohën dhe të ardhmen.
Territoret shqiptare gjatë sundimit osman (shek. XVI-shek. XVIII) Pashallëku i Shkodrës (1757-1831) Pashallëku i Janinës (1787 - 1822)	• shpjegon organizimin administrativ, legjislativ, ekonomik dhe shoqëror, të territoreve shqiptare nën Perandorinë Osmane; • analizon zhvillimin ekonomik e shoqëror të qyteteve shqiptare në shek. XVII-XVIII; • përcakton faktorët që ndikuan në përhapjen e islamizmit në tokat shqiptare. • tregon në hartë shtrirjen e Pashallëkut të Shkodrës dhe Janinës; • shpjegon rrugën e formimit të Pashallëkut të Shkodrës dhe reformat e ndërmarra në këtë pashallëk; • gjykon mbi marrëdhëniet e këtij Pashallëku me Perandorinë Osmane dhe Evropën; • tregon rrugën e formimit të Pashallëkut të Janinës dhe reformat e ndërmarra në këtë pashallëk; • gjykon mbi marrëdhëniet e këtij Pashallëku me Perandorinë Osmane dhe Evropën; • evidenton disa aspekte të jetës së përditshme në këto pashallëqe; • vlerëson rëndësinë e këtyre pashallëqeve në procesin e shtetformimit dhe

	ndërtimit të identitet kombëtar të shqiptarëve; • përshkruan karakteristika të kulturës, arkitekturës, arsimit dhe besimit gjatë kësaj periudhe;
Rilindja Kombëtare dhe tiparet e programit politik të Rilindësve shqiptarë Shqiptarët gjatë periudhës së Tanzimatit (1839-1879) Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj Përpjekjet e shqiptarëve për gjuhë dhe shkollë shqipe përgjatë shek. XIX Xhonturqit dhe shqiptarët (1908-1912) Kuvendi i Vlorës dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë	• shpjegon kushtet historike të fillesave të Rilindjes Kombëtare Shqiptare; • evidenton rolin e elitës intelektuale shqiptare në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare; • shpjegon tiparet e programit politik të rilindësve shqiptarë; • analizon kushtet dhe shkaqet që çuan në lindjen e çështjes shqiptare; • evidenton reformat e Tanzimatit dhe ndikimin e tyre në çështjen shqiptare; • gjykon mbi vendimet e Traktatit të Shën Stefanit dhe Kongresit të Berlinit; • shpjegon organizmin dhe platformën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; • evidenton përpjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e tërësisë tokësore shqiptare • gjykon mbi rolin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në ndërkombëtarizimin e çështjes kombëtare shqiptare dhe rritjes e vetëdijes kombëtare tek shqiptarët • evidenton përpjekjet e para të Rilindësve për ngritjen arsimore e kulturore të shqiptarëve; • evidenton përpjekjet për zhvillimin e arsimit në viset shqiptare, duke shpjeguar rolin e klerit në të; • përcakton momentet kyçe të lëvizjes kulturore-arsimore (1878-1900): • shpjegon ndikimin e Revolucionit të Turqve të Rinj në lëvizjen kulturore, arsimore dhe politike shqiptare; • argumenton vlerat e Kongresit të Manastirit dhe faktorët që përcaktuan fitoren e alfabetit latin; • gjykon mbi rëndësinë e Kongresit të Elbasanit (1909); • shpjegon kushtet që çuan në kryengritjet antiosmane të viteve 1910-1912; • analizon karakterin kombëtar dhe autonomist të Memorandumit të Greçës (1911); • përcakton karakterin e Luftës së parë Ballkanike dhe qëndrimin e

	shqiptarëve ndaj saj; • shpjegon kalimin nga platforma autonomiste në atë të Pavarësisë; • analizon vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlorës; • vlerëson rëndësinë e Shpalljes së Pavarësisë;

Koncepte dhe terma

Koalicion antiosman; territore vasale; Besëlidhje; ferman; sanxhak bej; haraç; vasalitet; diplomaci; aleanca; timar;spahinj; raja;esnafë; elajet; vilajet; ejalet; sanxhakë; nahije; kaza; pashallëk; sheriat; kanuname; venome; statut; vezir; islamizim; divani; vali, kleri, pashë, islamizim, lëvizje kombëtare; Rilindje Kombëtare; nacionalizëm; ideologji; Kanuni i Lidhjes së Prizrenit; Traktati i Shën Stefanit; Kongresi i Berlinit; diasporë; autonomi; pavarësi.

Projekte/situata të sugjeruara për tematikën "Shqiptarët në fund të shek. xiv – shek. xv"

Figura e Gjergj Kastriot Skënderbeut përmes letërsisë dhe artit shqiptar e botëror

- sjell aspekte të jetës dhe veprimtarisë së Skënderbeut nëpërmjet kinematografisë, teatrit, operës, letërsisë, pikturës, dhe skulpturës.

Roli i gruas në Rilindjen Kombëtare Shqiptare

- evidenton rolin e grave gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare për zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare.

Roli i diasporës në zgjimin e ndërgjegjes Kombëtare Shqiptare

- evidenton disa figura të rëndësishme të diasporës Shqiptare dhe vlerëson rolin e tyre në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare;

KLASA 12

TEMATIKA 4. SFIDAT E SHTETIT TË PAVARUR SHQIPTAR 1912 – 1939

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi përpjekjet e shteti shqiptar në vitet 1912-1914, për konsolidimin e pavarësisë dhe njohjen ndërkombëtare të tij. Tematika përshkruan veprimtarinë e qeverisë së përkohshme të Vlorës, liston vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për statusin, kufijtë dhe organizimin e shtetit shteti shqiptar , shpjegon qëndrimin e qeverisë së përkohshme të Vlorës ndaj vendimeve të Konferencës së Londrës si dhe përshkruan rrethanat e ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri dhe arsyet e largimit të tij. Tematika përshkruan pozitën e Shqipërisë gjatë Luftës së

Parë Botërore dhe trajtimin e çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris. Tematika trajton zhvillimet politike të shtetit shqiptar 1920-1924 dhe aspekte të jetës social - kulturore në Shqipëri gjatë kësaj periudhe. Nxënësit identifikojnë shkaqet e thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës duke listuar vendimet e këtij kongresi, evidenton lindjen e parlamentarizmit në Shqipëri, liston grupimet politike gjatë viteve 1920-1924, si dhe shpjegon arsyet që shkaktuan acarimin e jetës politike në Shqipëri të cilat kulmuan me Lëvizjen e Qershorit 1924. Ajo trajton organizimin e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1939 dhe gjendjen sociale ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Jugosllavi dhe të popullsisë çame në Greqi. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në **12 orë mësimore.** Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë projektesh/situata të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën "Projekte/situata të sugjeruara", në raportin 70% me 30%. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
Klasa 11 **Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës**	**Klasa 11** **Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**
Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (1912-1914) Konferenca e Ambasadorëve e Londrës (1912-1913) Shqipëria nën qeverisjen e princ Vilhelm Vidit Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore Shqiptarët e Kosovës, Çamërisë dhe viseve të tjera gjatë viteve 1912-1918 Çështja shqiptare në Konferencën e Paqes dhe Kongresi i Lushnjës Shteti shqiptar gjatë viteve 1921-1924	• përcakton shtrirjen e pushtetit të qeverisë së përkohshme së Vlorës • përshkruan veprimtarinë e qeverisë së përkohshme të Vlorës. • evidenton vështirësitë e brendshme dhe të jashtme të qeverisë së Vlorës për të ushtruar veprimtarinë e saj; • analizon vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për statusin, kufijtë dhe organizimin e shtetit shteti shqiptar; • shpjegon rrethanat e ardhjes së Princ Vidit në krye të shtetit shqiptar; • përshkruan organizimin e principatës shqiptarë të princ. Vilhelm Vidi • shpjegon arsyet e dështimit të qeverisjes së princ Vilhelm Vidi dhe largimin e tij; • përcakton në hartë ndarjen e territorit të Shqipërisë në zona pushtimi gjatë Luftës së Parë Botërore; • evidenton qëndrimin që mbajtën Fuqitë e Mëdha ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore; • nxjerr në pah detyrat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe reagimet e saj duke evidentuar Republikën e Korçës dhe Kongresin e Durrësit. • përshkruan dhe gjykon qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes

	shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris; • identifikon shkaqet e thirrjes së Kongresit Kombëtar të Lushnjës; • analizon vendimet e Kongresit të Lushnjës, duke evidentuar rëndësinë e tyre;. • Përshkruan veprimtarinë e qeverisë së Sulejman Delvinës dhe përpjekjet për shtrirjen e autoritetit qeverisës në të gjithë territorin e shtetit shqiptar • evidenton lindjen e parlamentarizmit në Shqipëri gjatë viteve 1920-1924; • shpjegon veprimtarinë e grupimeve kryesore politike gjatë viteve 1921-1924; • evidenton formën e organizimit të shtetit shqiptar sipas Statutit të Zgjeruar të Lushnjës; • shpjegon arsyet që shkaktuan acarimin e jetës politike në Shqipëri të cilat kulmuan me Lëvizjen e Qershorit të vitit 1924; • gjykon mbi arsyet e dështimit të Lëvizjes të Qershorit të vitit1924; • përshkruan aspekte të jetës social - kulturore në Shqipëri gjatë viteve 1921-1924;
Republika Shqiptare (1925-1928) Monarkia Shqiptare (1928-1939) Lëvizjet politike dhe shoqërore në Shqipëri gjatë viteve 1925-1939	• shpjegon rrethanat në të cilat u shpall Republika Shqiptare, duke evidentuar karakteristikat dhe organizimin shtetëror të saj • shpjegon përpjekjet e presidentit Ahmet Zogu për stabilizimin e situatës ekonomike dhe politike në Shqipëri; • përcakton drejtimet kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1928; • tregon rrugën e kalimit nga republika në monarki, duke evidentuar ndryshimet në organizimin shtetëror; • shpjegon marrëdhëniet me jashtë të shtetit shqiptar gjatë viteve 1925-1939; • dallon qëndrimin e grupimeve politike e shoqërore ndaj qeverisjes së

	Zogut në Shqipëri dhe jashtë saj; • përshkruan veçoritë e arsimit, kulturës dhe aspekte të jetës së përditshme gjatë republikës dhe monarkisë;

Koncepte dhe terma

Qeveri kombëtare; status ndërkombëtar, administrim ndërkombëtar, KNK, lëvizja vorio-epirote, asnjanësi, zona pushtimi, Traktati i fshehtë i Londrës, statut, vetëvendosje, parlamentarizëm, Paktet e Tiranës; grupime/parti politike; Republikë; monarki; senat; opozitë; reforma europianizuese; statut; kod civil; kod tregtar; kod penal; autoritarizëm, centralizim; stabilitet;

Projekte/situata të sugjeruara për tematikën "Shqiptarët në vitet 1912-1939"

Shqiptarët në Jugosllavi dhe Greqi në periudhën midis dy Luftërave Botërore

- përshkruan gjendjen social ekonomike dhe politike të shqiptarëve në Jugosllavi;
- përshkruan gjendjen social ekonomike dhe politike të popullsisë çame në Greqi;

Gruaja shqiptare në vitet '20-30

- evidenton përpjekjet e shtetit shqiptare në emancipimin e gruas;
- evidenton figurat kryesore femërore që spikatën në fusha të ndryshme në vitet 20-30;

TEMATIKA 5. SHQIPTARËT DHE LUFTA E DYTË BOTËRORE 1939 – 1944

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi pozitën e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo tematikë evidenton reagimin e grupimeve të ndryshme politike ndaj pushtuesit gjerman, njeh misionet e huaja që vepruan në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe tregon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe popullsisë çame në Greqi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Nëpërmjet kësaj tematike nxënësit aftësohen të shpjegojnë pasojat e Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në **7 orë mësimore**.

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë projektesh/situata të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën "Projekte/situata të sugjeruara", në raportin 70% me 30%. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Klasa 11 Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Klasa 11 Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
Shqipëria nën pushtimin e Italisë së Musolinit (prill 1939-shtator 1943) Shqipëria nën pushtimin gjerman (shtator 1943-nëntor 1944) Rezistenca shqiptare kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë Rrjedhojat e Luftës së Dytë Botërore për Shqipërinë	• shpjegon procesin e vendosjes së administratës italiane të pushtimit në Shqipëri; • analizon tiparet e regjimit fashist italian në Shqipëri; • përshkruan format e qëndresës së shqiptarëve kundër pushtuesve italianë; • analizon qëndrimet dhe programet e grupimeve kryesore politike jo fashiste në Shqipëri; • shpjegon mënyrën e administrimit të Shqipërisë gjatë pushtimit gjerman; • përshkruan qëndrimin e grupimeve të ndryshme politike jo fashiste ndaj pushtuesit gjerman; • diskuton mbi rolin dhe qëndrimin e misioneve të huaja që vepruan në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore; • shpjegon pasojat e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri; • vlerëson qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të rënët në luftë.
Koncepte dhe terma Bashkim personal; Asamble Kushtetuese; rezistencë; administratë pushtimi; Konferenca e Pezës; aleatë; mision ushtarak; Konferenca e Mukjes; Front Nacionalçlirimtar; Balli Kombëtar; Legaliteti; lëvizje nacionalçlrimtare; luftë civile; çlirim; dëme lufte; dëshmorë; qeveri kolaboracioniste; Dekalogu; Këshilli i Lartë i Rregjencës; Këshill Kombëtar.	
Projekte/situata të sugjeruara për tematikën "Shqiptarët dhe lufta e dytë botërore 1939 – 1944 **Shqiptarët e Kosovës dhe Çamërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore** • tregon qëndrimin e shqiptarëve në Kosovë dhe popullsisë çame në Greqi gjatë Luftës së Dytë Botërore. **Ese: Hebrenjtë dhe Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore**	

TEMATIKA 6. SHQIPËRIA GJATË REGJIMIT KOMUNIST 1945 – 1990

Përshkrimi i tematikës	
Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime mbi vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri, tiparet kryesore të këtij regjimi dhe pasojat që solli për Shqipërinë dhe Shqiptarët regjimi komunist, gjatë viteve 1944-1990. Kjo tematikë përshkruan gjendjen ekonomike, politike dhe aspekte të jetës së përditshme në Kosovë në vitet 1945-1990. Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në **12 orë mësimore**. Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë projektesh/situata të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën "Projekte/situata të sugjeruara", në raportin 70% me 30%. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.	
Klasa 11 **Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës**	**Klasa 11** **Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**
Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri Opozita shqiptare ndaj vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri Politika ekonomike e shtetit shqiptar (1946-1985) Arsimi , kultura dhe shoqëria në Shqipëri gjatë viteve 1945-1990 Politika e jashtme e shtetit shqiptar gjatë viteve 1945-1990 Tipare të represionit komunist gjatë viteve 1945-1990. Kriza e regjimit komunist (1985-1990) Shqiptarët në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1945-1990	• përshkruan procesin e vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri; • evidenton masat ekonomike dhe politike që mori regjimi komunist në Shqipëri gjatë viteve 1944-1948 duke gjykuar mbi pasojat e tyre; • shpjegon tiparet e qëndresës së forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit komunist në Shqipëri; • evidenton dhunën e ushtruar nga organet shtetërore ndaj opozitës demokratike dhe antikomuniste; • përcakton diktaturën e proletariatit dhe luftën e klasave si tipar kryesore ideologjik të regjimit komunist; • shpjegon politikat ekonomike të shtetit shqiptar, duke evidentuar shtetëzimin, centralizimin, planifikimin, industrializimin dhe kolektivizimin e bujqësisë si tiparet kryesore të saj; • gjykon mbi pasojat që patën politikat ekonomike në jetën e shqiptarëve; • përshkruan ndryshimet që pësoi shoqëria shqiptare në fushën e arsimit, artit, kulturës, fesë, shëndetësisë, rolit të gruas dhe jetës së përditshme; • evidenton ideologjizimin e arsimit, artit dhe kulturës shqiptare si pjesë të procesit të krijimit të "njeriut të ri"; • shpjegon pasojat që pati lufta e klasave dhe shkelja e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist;

	• liston format dhe metodat e ushtrimit të represionit nga shteti i diktaturës së proletariatit; • shpjegon pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Paris; • tregon drejtimet kryesore të politikës së jashtme të shtetit shqiptar; • përshkruan veçoritë e marrëdhënieve ndërshtetërore Shqipëri – Jugosllavi, duke evidentuar faktorët që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat; • shpjegon shkaqet e orientimit të ri politik të qeverisë shqiptare drejt BRSS pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë; • përshkruan marrëdhëniet me BRSS pas ardhjes së Hrushovit në krye të shtetit sovjetik; • evidenton faktorët që çuan në prishjen e marrëdhënieve me BRSS-në dhe pasojat; • shpjegon shkaqet e orientimit të ri politik të qeverisë shqiptare drejt Republikës Popullore të Kinës; • shpjegon tiparet e marrëdhënieve të qeverisë shqiptare me Kinën dhe ndikimin e tyre në shoqërinë shqiptare; • shpjegon shkaqet që çuan në prishjen e këtyre marrëdhënieve dhe pasojat e tyre. • përcakton veçoritë e politikës së qeverisë komuniste shqiptare, të cilat çuan në izolimin e plotë ndërkombëtar të vendit; • evidenton arsyet që çuan në krizën ekonomike dhe politike të shoqërisë shqiptare në gjysmën e dytë të viteve ’80; • identifikon disa nga tiparet e krizës ekomomike dhe përpjekjet e drejtuesve komunistë për të lehtësuar gjendjen; • përshkruan disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste; • përshkruan gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në

	Jugosllavi 1945-1968; • vlerëson Kushtetutën e vitit 1974 për Kosovën; • përshkruan rrugën e rivendosjes se autoritetit serb në Kosovë dhe pasojat e tij në pozitën e popullsisë shqiptare në Jugosllavi; • shqyrton aspekte të jetës së përditshme në Kosovë;

Koncepte dhe terma

Diktaturë e proletariatit, grupi i deputeteve, pozitë; kryengritje antikomuniste, parti-shtet, kulakë, shtetëzim, ekonomi e centralizuar, luftë klasash, sigurimi i shtetit, gjykatë popullore, republikë popullore, asamble kushtetuese, reforma agrare, KNER, Traktati i Varshavës, bllok i vendeve socialiste, revizionizëm, imperializëm, superfuqi, kolektivizim, industrializim, pronë shtetërore dhe kooperativiste, kult i individit, propagandë, disident, ekonomi e centralizuar dhe e planifikuar, bllokadë ekonomike, vetizolim, shkelje e të drejtave themelore të njeriut, kamp internimi, emancipim i gruas, ateizëm, ideologjizimi komunist.

Projekte/situata të sugjeruara për tematikën "Shqipëria gjatë regjimit komunist 1945 – 1990"

Jeta e përditshme në Shqipërinë komuniste

- përshkruan aspekte të jetës së përditshme të shqiptarëve gjatë viteve të regjimit komunist;

Fotomontazh mbi përdorimin e dhunës gjatë regjimit komunist

- vendos fotografi që shprehin këto dukuri: pamje nga burgjet e Spaçit, Burrelit, Qafë Barit etj; punët e rënda të burgosurve; jetën e të internuarve dhe kampet e internimit.

TEMATIKA 7. RËNIA E REGJIMIT KOMUNIST. FITORJA E DEMOKRACISË

Përshkrimi i tematikës

Përmes kësaj tematike, nxënësit demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime dhe vlera mbi periudhën e rënies së rrëgjimit komunist në Shqipëri dhe fitores së demokracisë. Nëpërmjet kësaj tematike, nxënësit mësojnë për përpjekjet e Shqipërisë për integrim në strukturat euroatlantike si dhe sfidat e shoqërisë shqiptare në ditët e sotme, gjithashtu ata vlerësojnë rëndësinë që pati për Kosovën shpallja e Pavarësisë.

Kjo tematikë sugjerohet të zhvillohet në **7 orë mësimore.**

Për tematikën e dhënë më poshtë janë parashikuar dhe orë projektesh/situata të sugjeruara të cilat jepen në rubrikën "Projekte/situata të sugjeruara", në raportin 70% me 30%. Këto orë mësuesi dhe autori i tekstit i integron brenda orëve të tematikës. Tematika së bashku me projektet realizojnë kompetencat lëndore dhe kompetencat kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Klasa 11 **Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës**	**Klasa 11** **Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës**
Lëvizja Studentore e Dhjetorit dhe shpallja e pluralizmit politik Shqipëria gjatë tranzicionit për në demokraci (1990-2013) Proceset e integrimit euroantantik i Shqipërisë (1990-2013) Rruga e Kosovës për pavarësi dhe integrim euro-atlantik	• përshkruan manifestimet e pakënaqësisë popullore që kulmuan me Lëvizjen e Studentore të Dhjetorit 1990; • përshkruan rrugën që çoi në vendosjen e pluralizmit politik dhe ndërrimin e pushteteve në Shqipëri (1991-1992); • përshkruan veçoritë e sistemit të ri politik ekonomik e shoqëror; • evidenton aspekte të globalizimit në jetën së përditshme në Shqipëri; • tregon sfidat e shtetit shqiptar në rrugën e integrimit euro-atlantik; • shpjegon faktorët që ndikuan në procesin e pavarësimit dhe të integrimit euro-atlantik të Kosovës ; • vlerëson rolin që luajtën ndërkombëtarët në këtë proces; • vlerëson rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën;
Koncepte dhe terma Kriza e regjimit komunist,demokraci, pluralizëm, fushatë elektorale, zgjedhje të lira, liri e shtypit,ekonomi e lirë e tregut, barazi para ligjit, tranzicion, integrimi euroatlantik, NATO, BE, marrëveshje stabilizim – asocimi, Pavarësia e Kosovës,administrim ndërkombëtar, UÇK,	
Projekte/situata të sugjeruara për tematikën "Rënia e regjimit komunist. Fitorja e demokracisë" **Qytetari në demokraci** • Evidenton rolin e qytetarit me të drejtat dhe detyrimet e tij në një sistem demokratik; • Analizon raportin shtet – individ në një shoqeri demokratike;	
Klasa 11 **Qëndrimet dhe vlerat** • Demonstron aftësitë bazë të kërkimit historik. • Vlerëson rëndësinë që ka e shkuara në ndërtimin e të tashmes. • Vlerëson rëndësinë e burimeve historike në ndërtimin objektiv të ngjarjes historike. • Shtron pyetje dhe gjen përgjigje,vlerëson burimet, identifikon dhe analizon interpretime të ndryshme dhe gjykon bazuar në argumente. • Respekton saktësinë e burimeve historike dhe dallon diferencën midis faktit dhe supozimit. • Vlerëson pozitën e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror.	

- Forcon ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë.
- Vlerëson zhvillimin e qytetërimit ilir;
- Vlerëson aftësinë e Skënderbeut në formimin e shtetit;
- Vlerëson marrëdhëniet e Skënderbeut me shtetet e tjera.
- Vlerëson rëndësinë historike që pati periudha e Skënderbeut;
- Vlerëson zhvillimin e marrëdhënieve feudale në territoret arbërore;
- Vlerëson rëndësinë e Pashallëkut të Shkodrës dhe të Janinës;
- Vlerëson rolin e Rilindjes kombëtare dhe rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë;
- Vlerëson sfidat e shtetit të pavarur shqiptar;
- Vlerëson përpjekjet e shtetit shqiptar për ruajtjen e tërësisë tokësore;
- Vlerëson qëndrimin e delegacioneve shqiptare në Konferencën e Paqes;
- Vlerëson qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe të rënët në luftë;
- Vlerëson lëvizjen demokratike në të gjithë vendin, zgjedhjet e 22 Marsit 1992 dhe fitoren e demokracisë;
- Vlerëson rolin e shtetit shqiptar në sfidën e integrimit evropian;
- Vlerëson shkaqet dhe pasojat e rezistencën së shqiptarëve në Jugosllavi dhe Greqi pas vitit 1913;
- Vlerëson rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën dhe rolin e ndërkombëtarëve në këtë proces;
- Vlerëson zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Kosovës sot;
- Respekton kontributin e shoqërisë shqiptare sot, për ndërkombëtarizimin e problemit çam;
- Demonstron, përmes studimit të historisë, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.
- Vlerëson rëndësinë e historisë në kuptimin e ngjarjeve të së shkuarës.
- Vlerëson gamën e burimeve historike dhe të informacionit, si: dokumentet, burimet e shtypura, historinë gojore, mediet e ndryshme, pikturat, muzetë, galeritë, fotografitë, muzikën dhe internetin, si baza për studimin dhe përshkrimin e një ngjarjeje historike.
- Vlerëson trashëgiminë kulturore botërore.
- Respekton origjinën historike dhe kupton dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë.
- Demonstron gatishmëri për të pranuar njerëzit nga komunitete të ndryshme.
- Shfaq krenari për vendin e tij.
- Vlerëson dhe respekton larminë në shoqëri, si dhe kontributin e kulturave dhe grupeve të ndryshme fetare e shoqërore.

- Tregon se disa ngjarje dhe ndryshime mund të interpretohen në mënyra të ndryshme dhe shpjegojnë arsyet e mundshme për këtë interpretim.
- Vlerëson dhe respekton pikëpamjet e të tjerëve.
- Tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit.
- Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.
- Është krijues dhe prezanton idetë e reja të tij.
- Demonstron interes dhe kuriozitet për historinë.
- Demonstron shpirtin e objektivitetit dhe paanësisë.
- Vetë vlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikat konstruktive në situata të thjeshta.
- Demonstron pavarësi dhe besim në vetvete.
- Respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë.
- Demonstron vullnet në arritjen e rezultateve.
- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përdorimi i një numri të larmishëm rrugësh dhe metodash në mësimin e historisë nga mësuesit është një përbërës thelbësor në procesin e zbatimit të kurrikulës së historisë, në arritjen e rezultateve të parashikuara të të nxënit, në aftësimin e nxënësve për ndërtimin dhe demonstrimin e kompetencave kyçe të të nxënit dhe kompetencave e koncepteve historike, në lidhjen e historisë me lëndët dhe fushat e tjera të të nxënit, në integrimin e temave ndërkurikulare, si dhe në zotërimin e cilësive historike për përmbushjen me sukses të qëllimeve arsimore.

Të nxënit në lëndën e historisë mund të realizohet vetëm me anë të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin e të nxënit, në mënyrë që ata të kuptojnë, të vlerësojnë e të përdorin përmbajtjen e synuar për të ndërtuar mbi të njohuri e aftësi të reja në situata të ndryshme me të cilat do të përballen në të ardhmen.

Edhe pse të nxënit në mënyrë të pavarur mbetet i rëndësishëm, po aq rëndësi ka edhe dhënia e mundësive me anë të metodologjisë së mësimdhënies për të ndërvepruar me njëri-tjetrin dhe me mjedisin ku jetojnë. Për këtë, shkolla duhet të ofrojë një mjedis mbështetës ku të njihet e të vlerësohet kontributi i secilit nxënës.

Mësuesi duhet të zbatojë në klasë teknika aktive të mësimdhënies dhe të nxënit. Ai duhet të organizojë aktivitete, të udhëzojë nxënësit për të marrë pjesë në to dhe të mundësojë pjesëmarrjen aktive dhe kuptimplote të nxënësve. Në këtë mënyrë nxënësit do të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për të nxënit e tyre, duke formësuar kështu aftësitë e para për të nxënit gjatë gjithë jetës.

Në shkallën e pestë të arsimit të mesëm të lartë, format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit, duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, me nivelin e nxënësve, me veçoritë e temave të ndryshme mësimore dhe në varësi të gjendjes së materialeve burimore dhe didaktike.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, gjatë shkallës së pestë të kurrikulës janë të shumta. Si të tilla mund të përdoren:

Mësimi zbulues nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre.

Biseda, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv;

Shpjegimi, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive dhe të proceseve historike.

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive në klasë, kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi është një përzierje e shpjegimeve, mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre, e transferimit dhe integrimit të njohurive dhe aftësive. Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin/en dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve,

ngjarjeve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e historisë. Gjithashtu, diskutimi është një rast shumë i mirë për të praktikuar të dëgjuarit te nxënësit, të folurën me radhë dhe aftësi të tjera që nevojiten në punën në grup.

Puna me faktet dhe përdorimi i burimeve: Përdorimi i strukturuar i dokumenteve historike ndihmon nxënësin të zhvillojnë përvojën për vlerësimin e fakteve dhe aftësinë për të formuluar gjykime të arsyeshme, ndaj mësuesi i historisë duhet ti nxisë nxënësit të përdorin burime të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe mësimin e tyre kritik e analitik e, në mënyrë të veçantë si :

- arkivat, duke lejuar në këtë mënyrë të shfrytëzohen dokumente origjinale;
- kinemaja dhe prodhimtaria audiovizuale, qoftë dokumentare, qoftë fantastike;
- bibliotekën;
- teknologjitë e informacionit, që duhet të përbëjnë objektin e një trajtimi kritik, individual e kolektiv, për të cilin mësuesi luan një rol themelor ;
- llojet e ndryshme të muzeve dhe vendet përkujtimore, që ndikojnë në përkapjen në mënyrë të qartë nga ana e nxënësve të ngjarjeve të fundit, konkretisht në përmasën e tyre të përditshme ;
- historia gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e të rinjve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në " historinë e shkruar".

Studimi kërkimor: Përfshirja në kërkim është pjesë përbërëse e programit të historisë. Duke njohur dhe duke përvetësuar mënyrën se si punojnë historianët, nxënësit zhvillojnë aftësinë për ta zbatuar atë gjerësisht në lëndën e historisë dhe në fusha të tjera.
Përdorimi i kërkimit historik u paraqet nxënësve një mënyrë për të bërë hulumtime, për të organizuar dhe për të shpjeguar ngjarjet që kanë ndodhur. Kërkimi historik është procesi i "të bërit histori". Ai është një proces ciklik (Figura. 1), që fillon me shtrimin e pyetjeve historike, pasohet nga gjetja dhe analiza e burimeve historike për të krijuar fakte dhe dëshmi historike. Dëshmia historike përdoret më pas për të ndërtuar interpretimet historike që kërkojnë t'iu përgjigjen pyetje historike.

Figura 1. Procesi i kërkimit historik

Përdorimi i kërkimit historik duhet të jetë në qendër të mësimit të historisë dhe mësuesit duhet t'i krijojnë mundësinë nxënësit për të mësuar aftësitë e nevojshme përmes praktikës dhe angazhimit në kërkimin historik. Përdorimi i pyetjeve në çdo njësi mësimore siguron një pikë kontakti për nxënësit për të kërkuar, sistemuar dhe analizuar informacion në përgjigje të çështjeve që hulumtohen në programin mësimor. Qasja kërkimore, kur zbatohet në mënyrë efektive, zhvillon cilësitë historike dhe aftëson nxënësit të jenë të pavarur, krijues dhe mendimtarë kritik. Ajo nxit demonstrimin e kompetencave historike dhe kompetencave kyçe të të nxënit. Tabela e mëposhtme paraqet një përforcim të qasjes kërkimore për të ndihmuar mësuesit në përdorimin e kësaj qasje.

Tabela 5. Përforcimi i qasjes kërkimore

Faza kërkimore	Cilësitë historike të një nxënësi	Qëllimi
1. Bën pyetje historike	• Kureshtar	Më e rëndësishme për procesin e kërkimit është pikënisja. Mësuesit duhet të udhëhiqen nga treguesit e mëposhtme: • angazhojnë interesin e nxënësve; • identifikojnë pyetjet që do të kërkojnë; (një pyetje e përgjithshme kërkimore e ndjekur nga nën-pyetje); • planifikojnë procesin e kërkimit; • përshkruajnë rezultatin.
2. Identifikon dhe gjen burimet përkatëse	• I logjikshëm • I balancuar	• Nxënësit vendosin cilat burime janë të dobishme, cilat nuk janë dhe cilat duhen trajtuar me kujdes (me anë të një shembulli mësuesit udhëzojnë paraprakisht nxënësit) • Nxënësit krijojnë fakte dhe dëshmi historike;
3. Analizon lidhjen shkak-pasojë	• I logjikshëm • I arsyetuar • I ditur	• Nxënësit analizojnë lidhjet shkak-pasojë për ndërtimin e ngjarjes duke u bazuar në burimet e gjetura;

4. Ndërton interpretime historike, vlerëson burimet dhe jep argumente	• I logjikshëm • I balancuar • Metodik • I arsyetuar • I ditur	• Nxënësit mbajnë shënime nga studimi i tyre për burimet. • Nëpërmjet reflektimit dhe diskutimit të drejtuar nga mësuesi, nxënësit janë në gjendje të zhvillojnë përgjigjet për pyetjet hetimore.
5. Kontrollon interpretimet e nxjerra dhe/ose interpretimin e tanishëm historik	• I balancuar • I arsyetuar • I ditur	• Nxënësit tregojnë zgjerimin, thellimin dhe transferimin e dijeve të tyre
6. Shpjegimi dhe komunikimi	• I logjikshëm • I arsyetuar • Metodik • I balancuar • I ditur	• Nxënësit shpjegojnë dhe prezantojnë përgjigjet e pyetjeve të tyre nëpërmjet medieve të ndryshme (me shkrim; me gojë; TIK); • Nxënësit respektojnë mendimet e shokëve të tyre qofshin ato dhe të ndryshme nga të tyret;

Nxënësit duhet të nxiten për të ndërmarrë, sipas nivelit që kanë dhe rrethanave, kërkime individuale me qëllim që të stimulohen kërshëria dhe fryma e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave si dhe mendimi i tyre sintetizues.

Në rrafshin grupor të nxënësve, të klasës apo shkollës, zhvillimi i projekteve kërkimore kolektive duhet të nxitet më tej, me qëllim që të krijohen kushtet e dialogut dhe ballafaqimit të hapur e tolerant të mendimeve.

Trajtimi ndërdisiplinor dhe shumëdisiplinor. Mësimi i historisë duhet të përdorë në çdo rast potencialin edukativ të një trajtimi ndërdisiplinor e shumëdisiplinor, duke vendosur lidhje me lëndët e tjera që përbëjnë tërësinë e kurrikulës shkollore, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore, përfshirë edhe lëndët shkencore.

Veprimtaritë praktike ose *projektet kurrikulare* kërkojnë zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi, intervista, vrojtimi, studimi i rastit, etj. Këto metoda e vënë theksin në ndërtimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës si dhe në demonstrimin e aftësive/shkathtësive, kryesisht aftësisë së punës me dokumentet historike, punës kërkimore, aftësisë për të punuar në grup, aftësisë për të zgjidhur problemin, etj,.

Trajtimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar. Sipas rrethanave, kërkohet të përkrahet zbatimi i projekteve ndërkombëtare dhe ndërkufitare, mbështetur mbi studimin e një teme të përbashkët, si dhe trajtimet krahasuese apo kryerja e një detyre të përbashkët në shumë shkolla të vendeve të ndryshme, duke përfituar konkretisht nga mundësitë e reja që japin teknologjitë e informacionit dhe vendosja e lidhjeve dhe këmbimeve shkollore.

Mësimi dhe ruajtja në kujtesë. Krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimi paqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, është e nevojshme të merren të gjitha masat edukative për të parandaluar përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur gjatë këtij shekulli si: Holokaustin, gjenocidin, spastrimet etnike, krimet e tjera kundër njerëzimit, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore me të cilat është lidhur në mënyrë të veçantë Këshilli i Evropës. *Për këtë qëllim, duhet :*

- të ndihmohen nxënësit për t'u njohur e ndërgjegjësuar me faktet dhe me shkaqet e atyre faktorëve që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi;
- të reflektohet mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmanget përsëritja e fakteve të tilla;
- të sigurohet zbatimi i vendimit të ministrave të edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkolla të një dite përkujtimore të Holokaustit dhe për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit;
- të kujtojë ashtu si Evropa, 27 janarin, si ditën përkujtimore të viktimave të Holokaustit dhe 23 gushtin, si ditën përkujtimore për viktimat e regjimeve totalitare naziste dhe komuniste;
- të pasurohet ndihma e veçantë e Këshillit të Evropës në fushën arsimore brenda Task Forces për bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me mësimin e Holokaustit, përkujtimin dhe kërkimin.

Teknologjitë e informacionit e të komunikimit. Në kontekstin e përdorimit shumë të zgjeruar të teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga ana e të rinjve, si gjatë jetës së tyre shkollore ashtu edhe jashtëshkollore, ka rëndësi të zhvillohet një pedagogji dhe metodologji që mban parasysh faktin që këto teknologji:

- përbëjnë burimet e pashmangshme në mësimin e historisë ;
- shtrojnë çështje themelore, konkretisht atë të besueshmërisë së burimeve ;
- u lejojnë mësuesve dhe nxënësve të depërtojnë në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta;
- zgjerojnë më së miri mundësinë për t'u futur në informacione dhe të dhëna historike;
- shumëfishojnë dhe lehtësojnë rastet e bashkëpunimit e të dialogut.

Nga ana tjetër, duhet gjithashtu të krijohen kushtet e nevojshme që mësuesi:

- të mund t'u vijë në ndihmë nxënësve gjatë procesit selektiv për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të informacionit;
- të mund të marrë masat e nevojshme për luftën kundër përhapjes së përmbajtjeve raciste, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sistemit internet, duke respektuar normat ligjore dhe lirinë e shprehjes;
- të mund të bëjë përpjekje gjatë orës së mësimit për analizë kritike, duke u mbështetur në larmi pikëpamjesh dhe interpretimesh ndërkulturore;
- të mund të nxisë nxënësit për të zhvilluar kompetencat e tyre, si analizat kritike dhe arsyetimin nëpërmjet analogjisë.

Gjatë orëve të ndryshme të mësimit, metodat e teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre, prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe e teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi.

Në ndihmë të zbatimit të këtyre metodologjive, në program parashtrohen një sërë veprimtarish të sugjeruara, të cilat i ndihmojnë nxënësit në zotërimin e kompetencave dhe në arritjen e rezultateve të të nxënit të parashikuara në program.

Mësuesi duhet të tregojnë kujdes të veçantë që nxënësit të nxiten vazhdimisht të reflektojnë në mënyrë kritike mbi ecurinë e të nxënit dhe punës së tyre në shkollë dhe të transferojnë ata ç'ka kanë mësuar në situata jetësore brenda dhe jashtë shkollës.

Mundësia për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga përvojat e lëndës së historisë ashtu si nga çdo lëndë tjetër në shkollë, duhet t'u ofrohet të gjithë nxënësve pa përjashtuar askënd për asnjë shkak. Mësimdhënia duhet të bazohet në interesin më të lartë të nxënësit dhe duhet të sigurojë trajtimin e barabartë me dinjitet e respekt të gjithsecilit.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Organizimi i kurrikulës sipas kompetencave, në fusha të nxëni, në shkallë, dhe me fokus integrimin, u krijon mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motivim, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. Në disa raste duhen bërë përshtatje të kurrikulës sipas diferencave të zhvillimit brenda një grupi moshor. Mësuesit mund të zgjerojnë zhvillimin e kompetencave kyçe si ato të komunikimit, të menduarit dhe shoqërore sipas nevojave individuale të nxënësve, për të zvogëluar dhe zhdukur diferencat brenda një shkalle të kurrikulës, në fund të saj.

Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të kompetencës, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zhvillojnë në mënyrë të vazhdueshme elemente specifike të kompetencave kyçe (p.sh.: aftësitë e nivelit të lartë konjitiv të kompetencës së të menduarit) dhe specifike të fushës, të fokusohen në çështjet kroskurrikulare, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

4.1. Materiale dhe burime mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe në procesin e të nxënit në lëndën e historisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies si dhe e bën mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projeksioni, CD, DVD, TIK, etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë ngjarjesh historike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv etj.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi është një aspekt i rëndësishëm i lëndës së historisë. Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave, fokusohet në matjen e njohurive e aftësive, në arritjen e rezultateve të të nxënit dhe në nivelin e përmbushjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi, e ndihmon mësuesin të evidentojë përparimin e nxënësve, të vlerësojë se sa të përshtatshme e të dobishme janë metodat e mësimdhënies që ai përdor, të përmirësojë mësimdhënien dhe t'i pajisë nxënësit me informacionin përkatës për progresin e tyre.

Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm që u shërben nxënësve për të ndjekur vetë ecurinë e tyre në këtë lëndë, për të njohur anët e tyre të forta dhe vështirësitë që hasin në zotërimin e njohurive dhe kompetencave, në mënyrë që të punojnë përkatësisht për përforcimin dhe kapërcimin e tyre. Vlerësimi është një informacion i rëndësishëm edhe për prindërit, me anë të të cilit ata mund të ndihmojnë më mirë në edukimin e fëmijëve të tyre.

I domosdoshëm është vlerësimi i përmbajtjes të lëndës lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive historike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre. (*p.sh. vetëvlerësimi, intervistë me një listë treguesish, testi objektiv, vëzhgimi i kërkimit historik me një listë të saktë treguesish, portofoli, prezantimi me gojë ose me shkrim, projekti kurrikular etj.)*

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, në përcaktimin e kohës së përshtatshme, në përzgjedhjen e materialeve për vlerësim mësuesi duhet të ketë parasysh:

- përcaktimin e qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhjen e veprimtarive, që mundësojnë demonstrimin e arritjes së kompetencave
- përdorimin e vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- dallimin qartë të qëllimit të detyrës së zgjedhur për vlerësim.

Vlerësimi i nxënësve duhet të nxjerrë në pah arritjet e tyre, në mënyrë që ata të inkurajohen të mësojnë me më shumë dëshirë. Ai duhet të konsiderohet si një mjet në ndihmë të nxënësve, i cili i ndihmon ata të njohin më mirë aftësitë e tyre në të nxënë, të

zhvillojnë e të përdorin talentet dhe aftësitë në mënyra sa më të dobishme. Nxënësit vetë duhet të jenë pjesë e procesit të vlerësimit të arritjeve të tyre.

Me anë të vlerësimit, mësuesi informohet rreth çfarë dhe si po mësojnë nxënësit, ç'ka e ndihmon atë të planifikojë mësimdhënien në vijim dhe të përgatisë materiale ose të rishikojë metodologjinë e mësimdhënies për t'iu përshtatur nevojave të nxënësve. Vlerësimi nga ana e mësuesit duhet të marrë në konsideratë edhe aftësinë e nxënësve për të përcaktuar e arritur objektiva për veten.

Mësuesi i historisë vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësit, aftësitë e tyre për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrim vetjak ndaj një ngjarjeje ose figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë, mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup si dhe aftësinë e tyre për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është edhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

a. Vëzhgimi

Mësuesi vlerëson ecurinë e nxënësve duke i vëzhguar ata gjatë punës individuale ose në grup si dhe ndërveprimin e tyre gjatë veprimtarive të ndryshme në klasë dhe në shkollë. *Mësuesi vëzhgon aspekte të tilla si:*

- aftësinë e nxënësve për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të bashkëpunuar në grup;
- ndërveprimet e nxënësve me njëri-tjetrin dhe me të rriturit;
- cilësinë e prezantimit të punimeve;
- interesat, aftësitë ose talentet e veçanta të nxënësve;
- pjesëmarrjen dhe interesin që shprehin nxënësit në veprimtari e aktivitete të ndryshme;

- përgjegjësinë vetjake dhe shoqërore që shfaqin nxënësit;
- përkushtimin dhe këmbënguljen e nxënësve në kryerjen e detyrave të ndryshme;
- nivelin e ndërgjegjësimit të nxënësve për vështirësitë që mund të kenë të tjerët dhe gatishmërinë për t'i ndihmuar ata;
- pyetjet që shtrojnë nxënësit, përgjigjet dhe sugjerimet që nxënësit u japin pyetjeve të mësuesit dhe nxënësve të tjerë;
- sjellje të caktuara, si: aftësitë drejtuese, niveli i vetëbesimit, të shprehurit në mënyrë të drejtpërdrejtë e të hapur, gatishmëria për të përballuar rreziqe, sfida e vështirësi;
- pjekurinë fizike dhe emocionale;
- aftësinë për të vetë-vlerësuar ecurinë në shkollë.

Mësuesi mund t'i mbajë shënim vëzhgimet për secilin nxënës, në mënyrë që të mund të krijojë një pamje të përgjithshme të ecurisë së zhvillimit të tyre. Kjo i shërben mësuesit edhe për t'ia komunikuar ecurinë e nxënësve prindërve të tyre ose në raste kur nxënësi ndryshon shkollë, ky lloj vlerësimi mund të ndahet me mësuesin e ri ose me mësuesit pasues të ciklit në vijim.
Vëzhgimi ndihmon vetë mësuesin i cili, pasi ka kuptuar nevojat e veçanta të secilit nxënës, duhet të rishikojë metodologjitë e mësimdhënies, në mënyrë që ato të lehtësojnë të nxënit e gjithsecilit.

b. Detyrat dhe testet

Me anë të detyrave të ndryshme që mësuesi u jep nxënësve në klasë, ai arrin të vlerësojë si procesin e punës, ashtu edhe nivelin e të kuptuarit të njohurive të reja nga ana e nxënësve. Me anë të detyrave, mësuesi mund të vlerësojë edhe aftësinë e nxënësve për t'i përdorur dijet e marra në situata nga më të ndryshmet. Detyrat në klasë mund të jenë projekte në grup ose punë individuale.
Një shembull i detyrës në klasë mund të jetë dhënia e një situate, e cila kërkon zgjidhje, ku nxënësit duhet të marrin një vendim së bashku dhe ta mbrojnë atë. Gjatë punës në grup të nxënësve, mësuesi vlerëson demonstrimin e kompetencave dhe aftësinë e gjithsecilit për të punuar në grup.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësuesi planifikon testime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa tematika, të cilët i bashkojnë rezultate të ndërlidhura të të nxënit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pak minutëshe për një objektiv të veçuar të të nxënit, tek ato një orësh; teste me alternativa ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është edhe testimi përfundimtar.

Mësuesi mund t'i përdorë testet me shkrim në fund të një tematike si një teknikë vlerësimi dhe vetëvlerësimi nga ana e nxënësve, pra t'i lejojë ata t'i korrigjojnë vetë testet për të reflektuar e për t'u ndërgjegjësuar mbi aftësitë e tyre dhe vështirësitë që ata hasin.

c. Projektet

Projektet i ndihmojnë nxënësit të përqendrohen në një temë të caktuar të programit, për shembull në njohjen e komunitetit ku ata jetojnë dhe studimin e tij në detaje. Me anë të projektit, mësuesi vlerëson aftësinë e nxënësve për të kërkuar informacion, për të mbledhur, për ta përpunuar dhe për ta prezantuar atë. Puna me projekte mundëson edhe vlerësimin e bashkëpunimit të nxënësve me njëri-tjetrin gjatë punës grup. Realizimi i një projekti është tregues edhe i përgjegjësisë vetjake dhe të grupit si dhe i përkushtimit dhe interesit të secilit nxënës.

d. Paraqitja dhe prezantimi i punimeve

Shpjegimi, paraqitja dhe prezantimi i punimeve të ndryshme që nxënësit realizojnë gjatë lëndës së historisë është për mësuesin tregues i aftësive të tyre për të mbledhur informacion, për ta përpunuar dhe për ta paraqitur atë. Gjatë paraqitjes dhe prezantimit të punimeve, nxënësit vlerësohen edhe për shtjellimin e këndvështrimeve të tyre, mbrojtjen e këtyre këndvështrimeve dhe mbajtjen e qëndrimit vetjak ose në grup ndaj një çështjeje të caktuar. Me anë të kësaj teknike vlerësohen kompetencat historike dhe kompetencat kyçe si ajo e komunikimit dhe e të menduarit. Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi/ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të

grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti. Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes sa më mirë të detyrave jashtë klase. Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

e. Dosja e nxënësit

Duke qenë se lënda e historisë synon aftësimin praktik të nxënësve, sugjerohet që nxënësit të mbajnë një dosje vetjake me punimet që kryejnë gjatë veprimtarive në klasë. Dosja i përngjan një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit.

Dosja e nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë një shkalle të caktuar të kurrikulës. Ajo mund të përmbajë listën e objektivave në fillim të vitit, anketat e përdorura gjatë një vrojtimi, burimet historike të përdorura për të kuptuar ndryshimin dhe vazhdimësinë, të tilla si: fotografi, pamje ose skica, vizatimet e kryera në klasë, poezi ose tregime mbi tema të caktuara historike, provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume, ese, artikuj publicistikë etj.

Dosja është një mjet i rëndësishëm për vlerësimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe që nxënësi demonstron në punimeve të ndryshme të arshivuara gjatë viteve në dosje, vetëvlerësimin e nxënësve, si dhe për vlerësimin e ecurisë së tyre nga ana e prindërve. Kjo dosje mund të përdoret edhe si informacion për ecurinë e nxënësve për mësuesit e rinj kur ata ndryshojnë shkollë ose për mësuesit e ciklit pasues.

Pavarësisht zgjedhjes nga ana e mësuesit të teknikave të vlerësimit, qofshin këto formale ose joformale, vlerësimi duhet domosdoshmërish të synojë përmirësimin e përvojave të të nxënit të nxënësve. Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor

dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstron arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarive dhe produkteve të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje ose figurë të caktuar historike, projekte etj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në njohuritë/aftësitë/qëndrimet e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato njohuri, aftësi dhe qëndrime që nuk përshkruhen në program.

ANEKS 1

Me qëllim që t'u vijë në ndihmë autorëve të teksteve të historisë dhe mësuesve të historisë në realizimin me sukses të këtij programi, në përvetësimin e dijeve dhe demonstrimin e kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës, paraqiten në këtë aneks, Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropën e shekullit të XXI.

Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in tëenty-first-century Europe

KËSHILLI I EVROPËS
KOMITETI I MINISTRAVE

Rekomandimet Rek (2001)15 e Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me mësimin e historisë në Evropë në shekullin XXI
(miratuar nga Komiteti i Ministrave,më 31 tetor 2001,në mbledhjen 771 të të Deleguarve të Ministrave)

Komiteti i Ministrave, në bazë të nenit 15.*b*. të Statutit të Këshillit të Evropës,

- duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është të realizojë një bashkim përherë e më të ngushtë midis anëtarëve të tij;

- duke vlerësuar Konventën kulturore evropiane nënshkruar në Paris, më 19 dhjetor 1954, që u bën thirrje shteteve të saj nënshkruese të nxisin studimin e historisë dhe të qytetërimit të palëve të tjera kontraktuese dhe ta zhvillojë atë në territorin e këtyre palëve kontraktuese ;
- duke rikujtuar Samitet e Vjenës (1993) dhe të Strasburgut (1997), gjatë të cilave kryetarët e shteteve e të qeverive të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës :
  - ✓ shprehën dëshirën ta shohin Këshillin e Evropës plotësisht në gjendje të ndihmojë për të përballur sfidat e shoqërisë së shekullit XXI ;
  - ✓ shprehën nevojën për të përforcuar mirëkuptimin e ndërsjellë dhe besimin midis popujve, në mënyrë të veçantë nëpërmjet një programi për mësimin e historisë, duke synuar heqjen e paragjykimeve dhe vlerësimin e ndikimeve pozitive të ndërsjella midis vendeve, feve e ideve të ndryshme, gjatë zhvillimit historik të Evropës;
- duke theksuar se falsifikimet dhe manipulimet ideologjike të historisë janë të papajtueshme me parimet themelore të Këshillit të Evropës përcaktuar nga Statuti i tij ;
- duke vlerësuar rekomandimet e Asamblesë parlamentare lidhur me përmasën evropiane të edukimit (Rekomandimi 1111 (1989)), përsa i përket historisë dhe mësimit të historisë në Evropë (Rekomandimi 1283 (1996)) ;
- duke rikujtuar Rezolutën n° 1 miratuar gjatë sesionit të 19-të të konferencës së përhershme të ministrave evropianë të edukimit lidhur me temën « Prirje dhe përputhshmëri për edukimin në Evropë » (Kristiansand, Norvegji, 1997), si dhe konkluzionet e rezolutat e sesionit 20-të të Konferencës së përhershme të ministrave evropianë të Edukimit lidhur me projektin « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » (Krakovi, Poloni, 2000) ;
- duke rikujtuar deklaratën e miratuar gjatë Konferencës informale të ministrave të Edukimit të Evropës Jug-Lindore, (Strasburg, 1999) me anë të së cilës u rekomandua të ndërmerren aksione pragmatike në fushat për të cilat Këshilli i Evropës ka një përvojë të gjatë e të njohur, konkretisht ndër të tjera mësimin e historisë ;

- duke marrë në konsideratë deklaratën e miratuar gjatë Konferencës rajonale të ministrave të Edukimit të shteteve të Kaukazit (Tbilisi, Gjeorgji, 2000) ;
- nisur nga Rekomandimi n° R (98) 5 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare lidhur me pedagogjinë trashëgimore, në të cilin Ministrat pohojnë se aksionet pedagogjike mbi trashëgiminë janë mjet i privilegjuar për t'i dhënë kuptim së ardhmes nëpërmjet një vështrimi më të mirë të së shkuarës ;
- duke u mbështetur në Rezolutën (98) 4 të Komitetit të Ministrave për itineraret kulturore të Këshillit të Evropës ;
- duke pasur parasysh Rekomandimin n° R (2000)1 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare mbi nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis kolektiviteteve apo autoriteteve territoriale në fushën kulturore, në të cilin ministrat theksojnë se veprimtaritë ndërkufitare u vijnë të rinjve në ndihmë për të krijuar një përfytyrim të ndërkufishëm, duke i bërë ata të ndjeshëm ndaj larmisë së traditave kulturore e historike ;
- nisur nga rezolutat e Konferencës së 5-të evropiane të ministrave përkatës të trashëgimisë kulturore (Portorož, Slloveni, 2001), në të cilat ministrat theksuan edhe një herë se mësimi i historisë duhet të mbështetet mbi kuptimin dhe shpjegimin e trashëgimisë, dhe të nxjerrë në pah karakterin ndërnacional të trashëgimisë ;
- duke pasur parasysh Rekomandimin n° R (2000) 13 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve anëtare për një politikë evropiane në fushën e komunikimit të arkivave, në të cilin ministrat, pasi vërejnë interesin në rritje të publikut për historinë dhe pasi theksojnë se një njohje më e mirë e historisë evropiane të vonshme mund të ndihmojë në parandalimin e konflikteve, bëjnë thirrje për një politikë evropiane në fushën e komunikimit të arkivave, mbështetur mbi parime që janë në përputhje me vlerat demokratike ;
- duke pasur në konsideratë Rekomandimin n° R (97) 20 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare lidhur me « gjuhën e urrejtjes », në të cilin gjuha e urrejtjes përkufizohet si përcaktuese e të gjitha formave shprehëse që përhapin, nxitin, shtyjnë a përligjin urrejtjen racore, ksenofobinë apo antisemitizmin, dhe në të cilin ministrat vërejnë se gjuha e urrejtjes mund të ketë një efekt më të dëmshëm kur përhapet nëpërmjet medieve ;

- duke mos harruar punimet e mëparshme të Këshillit të Evropës në fushën e mësimit të historisë që mbështeten mbi idenë e ripajtimit e të ndikimeve të ndërsjella pozitive midis popujve si punimet e kryera në periudhën e pasluftës, të cilat e vunë theksin në heqjen nga tekstet e historisë të njëanshmërive e paragjykimeve, punimet e njëpasnjëshme të projektit « Historia në Evropën e re », dhe programin « Mësimi i historisë dhe nisma e re e Sekretarit të Përgjithshëm », program që ndihmoi republikat e ish-Bashkimit sovjetik në përpunimin e metodologjive për modernizimin e mësimit të historisë, në nxjerrjen e teksteve të reja dhe rrjedhimisht ripërshtatjen e formimit të mësuesve ;
- duke u njohur me përfundimet e projektit « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » dhe me tërësinë e materialit pedagogjik në përdorim të mësuesve, që u paraqitën gjatë Konferencës përfundimtare të projektit « Vështrime të kryqëzuara mbi shekullin XX », mbajtur simbolikisht në Shtëpinë e Historisë së Republikës federale të Gjermanisë (Haus der Geschichte, Bon, Gjermani, 2001) ;
- duke vërejtur se projekti « Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX » lejoi ndër të tjera :
  - ✓ të bëhen përparime të ndjeshme në përpunimin e një koncepti pluralist e tolerant të mësimit të historisë, konkretisht nëpërmjet zhvillimit të aftësive kërkimore individuale dhe analizës ;
  - ✓ të vihen në dukje novacionet pedagogjike mbështetur si në teknologjitë e informacionit, ashtu edhe në burimet e reja didaktike;
  - ✓ të përpunohen shembuj trajtesash të hapura për çështjet e brishta të historisë së Evropës së shekullit XX,

U rekomandon qeverive të shteteve anëtare, brenda strukturave të tyre kushtetuese, rrethanave kombëtare a vendore dhe sistemit të tyre edukativ :

- të frymëzohen nga parimet që parashtrohen në shtojcën e këtij rekomandimi, në kuadrin e reformave të mësimit të historisë së sotme a të ardhme dhe të reformave lidhur me formimin e mësuesve të historisë;

- të bëjnë të mundur që, sipas procedurave të përshtatshme kombëtare, rajonale dhe lokale, organizmat e duhura publike e private të vendit të tyre të vihen në dijeni të parimeve që theksohen në këtë rekomandim nëpërmjet dokumenteve referues që përbëjnë bazën e tyre, veçanërisht tërësia e materialeve pedagogjike të përpunuara nga projekti « Të mësojmë e të arsimojmë historinë e Evropës së shekullit XX »;
- të zhvillojnë, sipas modaliteteve që duhen përcaktuar, veprimtari në fushën e mësimit të historisë, me qëllim që të forcohen marrëdhëniet e besimit e të tolerancës në gjirin e vetë shteteve dhe ndërmjet tyre, dhe t'u bëhet ballë sfidave të shekullit XXI;
- të përdorin gjithashtu, në mënyrë të integruar, projekte të tjera të Këshillit të Evropës, në mënyrë të veçantë atë të « Edukimit me qytetari demokratike » dhe punimet e realizuara në fushën e trashëgimisë kulturore ;

I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës t'ua bëj të ditur këtë rekomandim Shteteve palë të Konventës kulturore evropiane që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës.

Shtojcë për Rekomandimin Rek (2001)15

1. **Objektivat e mësimit të historisë në shekullin XXI**

Mësimi i historisë në një Evropë demokratike:

- duhet të zërë një vend themelor për formimin e individit si qytetar përgjegjës e aktiv për zhvillimin e respektit për tërë llojet e dallimeve, respekt i mbështetur mbi mirëkuptimin e identitetit kombëtar dhe të parimeve të tolerancës;
- duhet të jetë një faktor vendimtar pajtimi, mirënjohjeje, mirëkuptimi e besimi të ndërsjellë midis popujve;
- duhet të luajë rol kryesor në zhvillimin e vlerave të tilla themelore si toleranca, mirëkuptimi reciprok, të drejtat e njeriut dhe demokracia;

- duhet të përbëjë një nga elementët thelbësorë në ndërtimin e Evropës së bashkuar duke u bazuar në trashëgiminë historike e kulturore të përbashkët, pasuruar me larminë që e karakterizon, qoftë edhe në aspektet e veta konfliktuale dhe shpesh dramatike;
- duhet të jetë pjesë e një politike arsimore e cila luan një rol të drejtpërdrejtë në përparimin dhe zhvillimin e të rinjve, në perspektivën e ndërtimit, së bashku me ta, të një Evrope të së nesërmes, si dhe me zhvillimin paqësor të shoqërive njerëzore në një perspektivë globale, brenda frymës së mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë;
- duhet të lejojë të zhvillohet tek të rinjtë aftësia intelektuale për të analizuar e interpretuar informacionin në mënyrë kritike dhe me përgjegjshmëri, nëpërmjet dialogut, nëpërmjet kërkimit të dëshmive historike dhe nëpërmjet debatit të hapur e të bazuar në perspektivë të shumëfishta, sidomos për çështje të ndjeshme e të diskutueshme historike;
- duhet t'i lejojë qytetarit evropian të nxjerrë në pah identitetin e vet individual e kolektiv, nëpërmjet trashëgimisë së përbashkët historike në dimensionet e saj lokale, rajonale, kombëtare, evropiane dhe globale;
- duhet të jetë një instrument për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit.

2. Shtrembërimet e historisë

Mësimi i historisë nuk mund të jetë mjet manipulimi ideologjik, propagande apo nxitjeje të vlerave ultranacionaliste, ksenofobe, raciste apo antisemitiste e jotolerante.

Kërkimet historike dhe vetë historia që mësohet në shkollë, në asnjë rast, dhe me çfarëdo qëllimi qoftë, nuk mund të pajtohen me vlerat themelore dhe Statutin e Këshillit të Evropës po qe se ato lejojnë a popullarizojnë paraqitje të gabuara të historisë, nëpërmjet njërit a tjetrit prej mashtrimeve të mëposhtme :

- falsifikimit të fakteve historike, statistikave të rreme, pamjeve të trukuara, etj;
- ngulimit mbi një ngjarje të caktuar për të përligjur a fashitur një ngjarje tjetër ;
- shtrembërimit të së shkuarës për qëllime propagande ;
- interpretimit të tepruar nacionalist të së shkuarës, që mund të krijojë "ne" dhe "ata", ndarje në dy pjesë;

- shtrembërimeve burimore historike ;
- mohimit të fakteve historike ;
- mosveprimi me fakte të vërteta historike.

3. Dimensioni evropiane në mësimin e historisë

Duke qenë se ndërtimi evropian është, sa shprehje e një vendimi të hyrë lirshëm nga vetë evropianët, po aq sa dhe një realitet historik, do të ishte e përshtatshme në këtë rast :

- të nxirren në pah marrëdhëniet historike të vijueshme midis rrafsheve lokale, rajonale, kombëtare e evropiane ;
- të mbështetet mësimi i çasteve apo fakteve të historisë, përmasa evropiane e të cilave është e dukshme – në mënyrë të veçantë ngjarjet dhe rrymat historike e kulturore themeluese të ndërgjegjes evropiane ;
- të zhvillohen me të gjitha mjetet e mundshme, veçanërisht nëpërmjet teknologjive të informacionit, projektet e bashkëpunimit e të këmbimit midis shkollave mbi tema që kanë të bëjnë me historinë e Evropës ;
- të rritet interesi i nxënësve për historinë e vendeve të tjera evropiane ;
- të prezantohen dhe zhvillohen mësimdhënie në lidhje me historinë e ndërtimit të vetë Evropës.

Për të zhvilluar përmasën evropiane gjatë mësimit të historisë në një Evropë të zgjeruar, demokratike e paqësore, lypset :

- të mbahen parasysh rezultatet e punimeve të kryera në kuadrin e projektit “Të mësojmë e të arsimojmë historinë e Evropës së shekullit XX” të Këshillit të bashkëpunimit kulturor, si në përmbajtjen e tyre, ashtu edhe në trajtimin metodologjik;
- të ndërmerren, mbi bazën e programeve të Këshillit të Evropës, nisma lidhur me reformën e mësimit të historisë dhe përpunimin e teksteve të reja, si dhe të udhëzuesve metodologjikë, në kuadrin e veprimtarive për zhvillimin dhe forcimin e stabilitetit demokratik;
- të ndërmerren, mbi bazën e programeve të Këshillit të Evropës, nisma lidhur me sensibilizimin dhe pedagogjinë e trashëgimisë;

- të veprohet për shpërndarjen sa më të gjerë të materialit pedagogjik krijuar në kuadrin e projektit "Të mësojmë e të shpjegojmë historinë e Evropës së shekullit XX", duke përdorur teknologjitë e duhura të informacionit dhe komunikimit ;
- të fuqizohet ndihma për përgatitjen e programeve të reja shkollore dhe të normave për mësimdhënien e historisë, duke përfshirë përpunimin e teksteve të reja shkollore, konkretisht në Federatën e Rusisë, në vendet e Kaukazit, të Evropës Jug-Lindore dhe të rajonit të Detit të Zi;
- të përfitohet nga programi i Këshillit të Evropës për formimin e vazhdueshëm të personelit edukativ, me qëllim që të fitohen njohuri të reja në një kontekst evropian, gjatë të cilit mësuesit të mund të ballafaqojnë pikëpamjet dhe përvojat e tyre.

4. Përmbajtja e programeve

Mësimdhënia e historisë, ndërkohë që duhet të shmangë akumulimin e njohurive enciklopedike, duhet të përfshijë:

- sensibilizimin lidhur me përmasën evropiane, të mbajtur parasysh që gjatë përpunimit të programeve dhe kjo, me qëllim që nxënësit të fitojnë një "ndërgjegje evropiane" të hapur mbi botën;
- zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, të një gjykimi të pavarur e objektiv, dhe kundërvënien ndaj manipulimeve;
- ngjarjet dhe çastet e shënuara të historisë së Evropës, studiuar në rrafshe vendore, kombëtare, evropiane e botërore nëpërmjet periudhave dhe fakteve veçanërisht domethënëse;
- studimin e të gjitha dimensioneve të historisë së Evropës, jo vetëm politike, por edhe ekonomike, shoqërore e kulturore;
- zhvillimin e frymës kërkimore dhe të kërshërisë, konkretisht duke përdorur pedagogjinë e njohjes, në kuadrin e studimit të trashëgimisë, që lejon në këtë mënyrë të nxirren në pah ndikimet ndërkulturore;
- zhdukjen e paragjykimeve dhe stereotipive, duke theksuar në programe ndikimet e ndërsjella pozitive midis vendeve të ndryshme, feve dhe shkollave doktrinore në zhvillimin historik të Evropës;
- studimin kritik të shtrembërimeve të historisë, qoftë nëpërmjet mohimit të një fakti të dukshëm historik, qoftë nëpërmjet falsifikimit, shmangies, mosnjohjes, apo përdorimit ideologjik;

- studimin e çështjeve të diskutueshme, nëpërmjet mbajtjes parasysh të fakteve, të mendimeve e të pikëpamjeve të ndryshme, si dhe kërkimit të së vërtetës.

5. Metodat e mësimit

Përdorimi i burimeve

Do jetë me vend të përdoren burimet didaktike më të larmishme për njohjen e fakteve historike dhe mësimin e tyre kritik e analitik e, në mënyrë të veçantë :

- arkivat, të hapura për publikun, veçanërisht në vendet e Evropës qendrore e lindore, duke lejuar në këtë mënyrë të shfrytëzohen tashmë dokumente origjinale, kur asnjëherë më parë nuk ka ndodhur një gjë e tillë;
- kinemaja dhe prodhimtaria audiovizuale, qoftë dokumentare, qoftë fantastike ;
- teknologjitë e informacionit, që duhet të përbëjnë objektin e një trajtimi kritik, individual e kolektiv, për të cilin mësuesi luan një rol themelor ;
- llojet e ndryshme të muzeve të shekullit XX, ngritur gjithandej nëpër Evropë, dhe vendet përkujtimore, që ndikojnë në përkapjen në mënyrë të qartë nga ana e nxënësve të ngjarjeve të fundit, konkretisht në përmasën e tyre të përditshme ;
- historia gojore, me anë të së cilës dëshmitë gojore për ngjarjet e fundit historike mund ta bëjnë historinë më të gjallë në sytë e të rinjve, si dhe mund t'u lënë vend pikëpamjeve e perspektivave të atyre që nuk kanë marrë pjesë në « historinë e shkruar ».

Kërkimi individual

Nxënësit duhet të nxiten për të ndërmarrë, sipas nivelit që kanë dhe rrethanave, kërkime individuale, me qëllim që të stimulohen kërshëria dhe fryma e tyre vetëvepruese në vjeljen e të dhënave si dhe mendimi i tyre sintetizues.

Kërkimi kolektiv

Në rrafshin grupor të nxënësve, të klasës apo shkollës, zhvillimi i projekteve kërkimore a arsimore aktive duhet të nxitet më tej, me qëllim që të krijohen kushtet e dialogut dhe ballafaqimit të hapur e tolerant të mendimeve.

Trajtimi ndërdisiplinor dhe shumëdisiplinor

Mësimi i historisë duhet të përdorë në çdo rast potencialin edukativ të një trajtimi ndërdisiplinor e shumëdisiplinor, duke vendosur lidhje me disiplinat e tjera që përbëjnë tërësinë e programit shkollor, konkretisht me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore, filozofinë, artet, përfshirë edhe disiplinat shkencore.

Trajtimi ndërkombëtar dhe ndërkufitar

Sipas rrethanave, lypset të përkrahet zbatimi i projekteve ndërkombëtare dhe ndërkufitare, mbështetur mbi studimin e një teme të përbashkët si dhe trajtimet krahasuese apo kryerja e një detyre të përbashkët në shumë shkolla të vendeve të ndryshme, duke përfituar konkretisht nga mundësitë e reja që japin teknologjitë e informacionit dhe vendosja e lidhjeve dhe këmbimeve shkollore.

6. Mësimi dhe ruajtja në kujtesë

Krahas nxjerrjes në pah të arritjeve pozitive që kanë karakterizuar shekullin XX, si përdorimi paqësor i shkencave për një art më të mirë të jetuari dhe zhvillimi i demokracisë e të drejtave të njeriut, është e nevojshme të merren të gjitha masat edukative për të parandaluar përsëritjen apo mohimin e ngjarjeve shkatërrimtare që kanë ndodhur gjatë këtij shekulli, domethënë Holokaustin, gjenocidin dhe krimet e tjera kundër njerëzimit, spastrimet etnike, dhunimet masive të të drejtave të njeriut dhe të vlerave themelore me të cilat është lidhur në mënyrë të veçantë Këshilli i Evropës. Për këtë qëllim :

- duhet të ndihmohen nxënësit për t'u njohur e ndërgjegjësuar me faktet dhe me shkaqet e tyre që kanë karakterizuar në mënyrën më të errët historinë e Evropës në veçanti dhe atë të botës në përgjithësi ;
- duhet të reflektohet mbi ideologjitë që kanë çuar në to dhe mbi mjetet që bëjnë të mundur të shmanget përsëritja e fakteve të tilla ;
- duhet të orientohen, zhvillohen e bashkërendohen programet e formimit të vazhdueshëm të personelit edukativ në shtetet anëtare të Këshillit të bashkëpunimit kulturor ;

- duhet të lehtësohet futja në dokumentacionin që zotërohet për këtë temë, duke përdorur konkretisht burimet e teknologjive të reja dhe të zhvillohet një rrjet qendrash burimore pedagogjike në këtë fushë ;
- duhet të sigurohet zbatimi, ndjekja dhe kontrolli i vendimit të ministrave të Edukimit (Krakovi2000) lidhur me caktimin në shkolla të një dite përkujtimore të Holokaustit dhe për parandalimin e krimeve kundër njerëzimit, në përshtatje me historinë e secilit vend anëtar ;
- duhet të pasurohet ndihma e veçantë e Këshillit të Evropës në fushën arsimore brenda Task Forces për bashkëpunimin ndërkombëtar lidhur me mësimin e Holokaustit, përkujtimin dhe kërkimin.

7. Formimi paraprak e i vijueshëm i mësuesve të historisë

Formimi i veçantë dhe i vijueshëm i mësuesve të historis:

- duhet të formojë e të nxisë mësuesit e historisë për të përdorur metoda komplekse për orën e historisë, duke u thelluar në reflektimin dhe duke u mbështetur në kërkimin ;
- duhet të synojë që mësuesit e historisë dhe ata që tashmë janë përfshirë në jetën aktive të njohin tërë produktet, mjetet dhe metodat e fundit, veçanërisht përdorimin e teknologjive të informacionit e komunikimit ;
- duhet t'i bëjë mësuesit të ndjeshëm për të zbatuar praktika pedagogjike të cilat, mbi bazën e të dhënave faktike dhe përtej tyre, synojnë që nxënësit të arrijnë të interpretojnë e analizojnë faktet historike dhe ndikimin e tyre mbi të tashmen, në kontekste të ndryshme shoqërore, gjeografike, ekonomike, etj. ;
- duhet t'i ndihmojë mësuesit të zbatojnë praktika vlerësuese, të cilat mbajnë parasysh jo vetëm të dhënat që memorizojnë nxënësit, por edhe veprimtaritë që ata janë në gjendje të ndërmarrin, mbi bazën e njohjes të të dhënave në fjalë, si kërkimet, debatet apo analizat e çështjeve për diskutim ;
- duhet t'i ndihmojë të konceptojnë e të realizojnë në klasa situata mësimi të një natyre ndërdisiplinore, në bashkëpunim me kolegët e tyre.

Duke qenë se teknologjitë e informacionit dhe komunikimit çojnë në shndërrimin e rolit të mësuesve të historisë, është e rëndësishme:

- të krijohen pika këmbimi, me qëllim që mësuesit të njihen me gamën e gjerë të situatave mësimore në të cilat integrohen rolet e reja në fjalë ;
- të mbështetet krijimi i grupeve për kapërcimin e vështirësive, ngurrimeve dhe dyshimeve profesionale lidhur me këto praktika të reja pedagogjike ;
- të zhvillohen bankat burimore, që paraqesin jo vetëm dokumentet dhe rrjetet e zotërueshme, por edhe vlerën e informacioneve të ardhura nga këto burime dhe dokumente.

Me qëllim që të arrihen këto objektiva dhe të përcaktohet profili i veçantë i mësimit të historisë, lypset:

- t'u jepet institucioneve për formimin e mësuesve të historisë mbështetja e nevojshme për të ruajtur e përmirësuar cilësinë e formimit të tyre, dhe për të zhvilluar profesionalizmin, e në mënyrë të veçantë statusin shoqëror të mësuesve të historisë ;
- t'i kushtohet vëmendje e posaçme formimit të mësuesve të historisë sipas parimeve që përmban ky rekomandim ;
- të nxiten kërkimet krahasuese lidhur me këto objektiva, struktura e norma të formimit të veçantë, paraprak e të vijueshëm të mësuesve të historisë dhe mbi bazën e kësaj, të gjallërohet bashkëpunimi institucional dhe këmbimi i informacioneve sipas nevojave të domosdoshme për reformat e formimit paraprak e të vijueshëm të mësuesve të historisë;
- të krijohen e fuqizohen partneritetet në tërësinë e institucioneve aktive në fushën e formimit të mësuesve të historisë apo që kanë të bëjnë me këtë formim (veçanërisht mediet), me qëllim që të nxirret në pah misioni dhe përgjegjësia e tyre e veçantë.

8. Teknologjitë e informacionit e të komunikimit

Duke respektuar normat ligjore dhe lirinë e shprehjes, lypset të merren masat e nevojshme për luftën kundër përhapjes së përmbajtjeve raciste, ksenofobe apo revizioniste, në mënyrë të veçantë nëpërmjet sistemit Internet.

Në kontekstin e përdorimit shumë të zgjeruar të teknologjive të informacionit dhe komunikimit

nga ana e të rinjve, si gjatë jetës së tyre shkollore ashtu edhe jashtëshkollore, ka rëndësi të zhvillohet një pedagogji dhe metodologji që mban parasysh faktin që këto teknologji :

- përbëjnë burimet e pashmangshme në mësimin e historisë ;
- shtrojnë çështje themelore, konkretisht atë të besueshmërisë së burimeve ;
- u lejojnë mësuesve dhe nxënësve të depërtojnë në burime origjinale dhe interpretime të shumëllojta ;
- zgjerojnë më së miri mundësinë për t'u futur në informacione dhe të dhëna historike ;
- shumëfishojnë dhe lehtësojnë rastet e bashkëpunimit e të dialogut

Nga ana tjetër, do duhet gjithashtu të krijohen kushtet e nevojshme që mësuesit:

- të mund t'u vijnë në ndihmë vetë nxënësve, gjatë procesit selektiv, për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve të informacionit dhe vetë informacionet si të tilla ;
- të mund të bëjnë gjatë orës së mësimit përçapje për analizë kritike, duke u mbështetur në larmi pikëpamjesh dhe interpretimesh ndërkulturore ;
- të mund të nxisin nxënësit për të zhvilluar kompetencat e tyre, si analizat kritike dhe arsyetimin nëpërmjet analogjisë.

---

[i] Recommendation Rec(2001)15 of the Committee of Ministers to member states on history teaching in tëenty-first-century Europe; Recommendation CM/Rec (2011)6 of the Committee of Ministers to member states on intercultural dialogue and the image of the other in history teaching